LIGJ
Nr. 69/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR TË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR PUNËT E KOMUNITETIT IV TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, PROJEKTI "ZHVILLIMI I ALPEVE SHQIPTARE DHE ZONAVE BREGDETARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja kuadër e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës për punët e komunitetit IV të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, projekti "Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe zonave bregdetare", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9172, datë 14.7.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LD1853 (2014)
SDA-13-TA (2014)

MARRËVESHJA
KUADËR E FINANCIMIT NDËRMJET BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), Punët në Komunitetin IV "Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare" - Hua Projekti me Asistencë Teknike të financuar nëpërmjet Grantit SDA

TABELA E LËNDËS

Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës, Organizatë Ndërkombëtare, me seli në Paris (Francë), në adresën 55, Avenue Kléber, F-75116,

(këtu e tutje referuar si "CEB" "Banka"), nga njëra anë dhe Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave (më poshtë i referuar si "Huamarrësi" në kuadër të Huas (siç përcaktohet më poshtë), "Vendi përfitues" në kuadër të grantit SDA (siç përcaktohet më poshtë) dhe së bashku me CEB, "Palët" secila "Palë"), nga ana tjetër,

meqenëse:

A. Duke marrë në konsideratë aplikimin për huamarrje dhe kërkesën për grantin SDA të dorëzuar nga Republika e Shqipërisë si shtet anëtar i Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, në datën 23 tetor 2014 dhe të aprovuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it më 6 nëntor 2014;

B. Duke marrë në konsideratë Protokollin e Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës, të datës 6 mars 1959;

C. Duke marrë në konsideratë Rregulloren e Huas së CEB-it, siç është miratuar nga Rezoluta 1562 (2013) e Këshillit Administrativ të CEB-it (më poshtë e referuar si "Rregullorja e Huadhënies");

D. Duke marrë në konsideratë Politikat e CEB-it për Huadhënien dhe financimin e projekteve (këtu e tutje referuar si "Politikat e Huadhënies"), siç është miratuar nga Rezoluta 1562 (2013) e Këshillit Administrativ të CEB-it;

E. Duke marrë në konsideratë politikat mjedisore të CEB-it, siç është miratuar nga Rezoluta 1530 e

Këshillit Administrativ të CEB-it (2010) (më poshtë të referuara "Politikat mjedisore");

F. Duke marrë në konsideratë Udhëzimet e Prokurimit të CEB-it, siç është miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it në shtator 2011 (më poshtë të referuara si "Udhëzimet e Prokurimit");

G. Duke marrë në konsideratë politikat e CEB-it mbi llogarinë e dividendit social (më poshtë i referuar si "SDA"), siç është miratuar nga Rezoluta 1554 e Këshillit Administrativ të CEB-it (2013) (më poshtë të referuara si "Politikat e SDA-së");

H. Duke marrë në konsideratë politikat e SDA-së, Këshilli Administrativ i CEB-it ka aprovuar në bazë të miratimit të Projektit prej tij, më 6 nëntor 2014, një kontribut në formë granti nga SDA për vendin përfitues në shumën e përgjithshme maksimale prej 1,000,000 eurosh (më poshtë i referuar si "Granti SDA") për financimin e asistencës teknike të nevojshme për përgatitjen dhe zbatimin e Projektit, siç shtjellohet më tej në shtojcën 5 të kësaj Marrëveshjeje "AT e Projektit";

I. Duke marrë në konsideratë që vendi përfitues, ka dhënë aprovimin e tij të plotë për Grantin SDA, për zbatimin e Projektit dhe Asistencën Teknike të Projektit siç parashikohet në këtë Marrëveshje,

si rrjedhojë, palët bien dakord si më poshtë:

1. INTERPRETIMET

1.1 Përkufizimet

Termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

"Marrëveshje" do të thotë kjo marrëveshje kuadër financimi, duke përfshirë shtojcat e saj.

"Alokim" do të thotë: i) në kontekstin e Huadhënies, detyrimi financiar i një Transhi Huaje nga Huamarrësi për pjesët përbërëse të aprovuara të Projektit siç përcaktohet në shtojcën 1, edhe nëse ky Transh nuk do të ishte paguar akoma në kuadër të Projektit; dhe ii) në kontekstin e Grantit SDA, detyrimi financiar nga vendi përfitues për aktivitetet e aprovuara të AT-së së Projektit, siç specifikohet në shtojcën 5, edhe nëse një Transh i tillë Granti nuk do të ishte paguar ende sipas AT-së së Projektit.

"Periudha e Alokimit" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 6.2.

"Ditë Pune" nënkupton:

Në lidhje me pagesat në euro, çdo ditë në të cilën operon TARGET 2 (Sistemi Automatik Trans Evropian i Transfertave në Kohë Reale).

"Data e Mbylljes" nënkupton datën 30 shtator 2019, duke qenë data: i) e specifikuar në shtojcën 1 (Përshkrimi i Projektit) nga e cila nuk mund të kërkohen nga Huamarrësi disbursime të mëtejshme të Huas; dhe ii) siç specifikohet në shtojcën 5 (Përshkrimi i AT-së së Projektit) nga e cila nuk mund të kërkohen më nga vendi përfitues disbursime të mëtejshme nga Granti SDA.

"Raporti i Përfundimit" ka kuptimin e specifikuar në nënklauzolën 7.1.

"Monedha" nënkupton euron, për qëllimet e Marrëveshjes.

"Konventa e Përcaktimit të Ditëve" nënkupton marrëveshjen për përcaktimin e numrit të ditëve ndërmjet dy datave dhe numrin e ditëve për vit siç përcaktohet në Njoftimin Përkatës të Disbursimit;

"Instrumenti i borxhit" do të thotë: i) çdo hua ose formë tjetër e borxhit financiar; ii) një instrument, duke përfshirë një dëftesë ose pasqyrë llogarie, që provon ose përbën një detyrim për të shlyer një hua, depozitë, parapagim apo shtyrje të ngjashme të kredisë (duke përfshirë pa kufizim çdo shtyrje të kredisë në bazë të një marrëveshjeje rifinancimi dhe riplanifikimi); iii) një detyrim të provuar nga një obligacion, dëftesë borxhi apo provë e ngjashme me shkrim për qenien në borxh; ose iv) një instrument që provon një garanci të një detyrimi që rrjedh nga një instrument borxhi te një tjetër.

"Përqindja e kamatëvonesës" do të ketë kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 4.9.

"Data e disbursimit" është data në të cilën është planifikuar disbursimi i Transhit në përputhje me njoftimin e aplikueshëm të Disbursimit.

"Njoftimi i disbursimit" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 4.3/b.

"Kërkesë disbursimi" ka kuptimin sipas kontekstit ose kërkesë disbursimi granti ose kërkesë disbursimi Huaje.

"Konfirmimi i rimbursimit të parakohshëm" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 4.7.

"Shpenzimet e rimbursimit të parakohshëm" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 4.7.

"Data e rimbursimit të parakohshëm" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 4.7.

"Njoftimi i rimbursimit të parakohshëm" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 4.7.

"Data e hyrjes në fuqi" nënkupton datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, që përcaktohet në klauzolën 18.

"BE" do të thotë Bashkimi Evropian.

"Direktivat e prokurimit të BE-së" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 6.5.

"EURIBOR nënkupton normën e përqindjes në vit (të rrumbullakosur me pikën e përqindjes të njëqindtë, të njëmijtë më të afërt, me gjysmat e rrumbullakosura) të publikuar në faqen e Reuters EURIBOR 01 (ose në një faqe pasuese, e cila zëvendëson faqen Reuter EURIBOR 01) në orën ose rreth orës 11:00, ora e Brukselit, në ditën e përcaktimit të normës së interesit, të njëjtë me atë të Bankës Qendrore të BE-së për depozitat në euro në tregun ndërbankar të eurozonës.

Nëse një periudhë përkatëse e interesit nuk është e njëjtë me periudhën e cituar nga Reuter, EURIBOR-i i aplikueshëm do të jetë norma e përqindjes në vit, e cila rezulton nga interpolimi linear nëpërmjet referimit të 2 (dy) normave të interesit EURIBOR për depozitat në euro, njëra prej të cilave është e zbatueshme për një periudhë të ardhshme më të shkurtër, muaj të plotë dhe tjetra për një periudhë të ardhshme më të gjatë prej muajsh të plotë sesa gjatësia e periudhës përkatëse të interesit.

"Euro" dhe simboli "EUR" nënkuptojnë monedhën e ligjshme të shteteve anëtare të BE-së, të cilat herë pas here e miratojnë atë si monedhën e tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse të Traktatit të BE-së dhe Traktatit për Funksionimin e BE-së apo traktatet e tjera vijuese.

"Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut" nënkupton Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të datës 4 nëntor 1950, Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës, CETS nr. 5, e ndryshuar herë pas here.

"Karta sociale Evropiane" do të thotë Karta Evropiane Sociale, e datës 3 maj 1996, Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës, CETS nr. 163, e ndryshuar herë pas here.

"Përfituesit përfundimtarë" janë specifikuar në shtojcën 1 të këtij dokumenti, si grupi përfitues i ndikimeve sociale të Projektit.

"Norma fikse e interesit" nënkupton normën e interesit në vit të caktuar në njoftimin e zbatueshëm të disbursimit.

"Norma e ndryshueshme e interesit" do të thotë norma vjetore e interesit që përcaktohet duke shtuar ose duke zbritur, sipas rastit, nga Norma e Referencës, diferencën e specifikuar në njoftimin e zbatueshëm të disbursimit.

Për të shmangur paqartësitë, kur përcaktimi i normës së ndryshueshme të interesit rezulton në një normë negative interesi (për shkak të një norme negative reference të kuotuar, për arsye të kryerjes së një diference që është zbritur nga norma e referencës ose në çfarëdo rrethanash të tjera), interesi për t'u paguar nga Huamarrësi për periudhën e interesit konsiderohet të jetë zero.

"Kërkesa për disbursim Granti" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 5.2.

"Transhi i Grantit" nënkupton një shumë të disbursuar ose që do të disbursohet nga Granti SDA.

"Data e përcaktimit të normës së interesit" do të thotë, për qëllimet e përcaktimit të një norme të ndryshueshme interesi, dita që i bie 2 (dy) ditë pune para ditës së parë të periudhës së interesit, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin përkatës të disbursimit.

"Datat e pagesave të interesit" nënkupton datat për pagesën e interesit që korrespondojnë me periudhën përkatëse të interesit të specifikuar në njoftimin e zbatueshëm të disbursimit.

"Periudha e interesit" nënkupton periudhën që fillon në një datë pagese interesi dhe mbaron menjëherë një ditë para datës pasardhëse të pagesës së interesit, me kusht që periudha e parë e aplikueshme e interesit për secilin transh të fillojë në datën e disbursimit dhe të përfundojë menjëherë një ditë para datës së ardhshme të pagesës së interesit.

"Huaja" nënkupton huan që i është alokuar Huamarrësit nga CEB-i, në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

"Shuma e Huas" nënkupton shumën e specifikuar sipas nënklauzolës 4.1.

"Kërkesa për disbursim Huaje" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 4.3/a.

"Transhi i Huas" nënkupton një shumë të disbursuar ose që do të disbursohet nga Huaja.

"Ngjarje e deformimit të tregut" ka kuptimin që i është dhënë në nënklauzolën 4.10.

"Ndryshim thelbësor me pasoja negative" nënkupton çdo ngjarje e cila sipas gjykimit të CEB-it: i) dëmton thelbësisht aftësinë e Huamarrësit për të kryer obligimet e tij financiare sipas Marrëveshjes; ose ii) ndikon negativisht në ndonjë garanci të ofruar nga Huamarrësi ose një palë e tretë për të garantuar performancën e duhur të detyrimeve financiare të Huamarrësit sipas Marrëveshjes.

"Data e maturimit" nënkupton datën e fundit të shlyerjes së principalit për secilin transh të specifikuar në njoftimin e zbatueshëm të disbursimit.

"Konventa për ndryshimin e ditës pasardhëse të punës" nënkupton një marrëveshje sipas së cilës nëse një datë e përcaktuar bie në një ditë e cila nuk është ditë pune, atëherë do të llogaritet data pasardhëse që është ditë pune, përveç rasteve kur kjo ditë kalon në muajin pasardhës kalendarik, në një

rast të tillë data specifike do të jetë dita paraardhëse që i bie të jetë ditë pune.

"Data/datat e shlyerjes së principalit" nënkupton datën ose datat për shlyerjen e principalit sipas secilit transh të përcaktuar në njoftimin e zbatueshëm të disbursimit.

"Periudha e shlyerjes së principalit" nënkupton, në lidhje me çdo transh, periudhën që shtrihet nga data e disbursimit të principalit deri në datën e maturimit.

"Raporti i progresit" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 7.1.

"Praktikat e ndaluara" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 6.8.

"Projekti" nënkupton skemat e aprovuara të investimit, të parashtruara në shtojcën 1, të cilat do të financohen pjesërisht nëpërmjet Huas së aprovuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it, me ref. LD 1853 (2014).

"Llogaria e projektit" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 4.2.

"Njësia zbatuese e projektit" (që këtej e tutje do të referohet "NJZP") nënkupton Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), një agjenci zbatuese publike e themeluar nëpërmjet një vendimi qeveritar të Republikës së Shqipërisë, në janar 1993, e cila operon në përputhje me ligjin nr. 10130 "Mbi fondin shqiptar të zhvillimit", datë 11 maj 2009, me zyrë kryesore në adresën: rruga "Sami Frashëri", nr. 10 Tiranë, Shqipëri, si person juridik, që nëpërmjet delegimit nga Huamarrësi, është përgjegjëse për zbatimin e projektit dhe të asistencës teknike të projektit.

"AT e projektit" nënkupton aktivitetet e aprovuara sipas përcaktimit në shtojcën 5, që do të financohen nëpërmjet Grantit SDA të aprovuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it me ref. SDA-13-TA (2014), në mbështetje të Projektit.

"Statusi i parashikuar i progresit të punëve" do të thotë: i) në kontekstin e Huas, raporti i shpenzimeve të pranueshme, për të gjitha pjesët përbërëse, kundrejt totalit të kostos së pranueshme të projektit të specifikuar në shtojcën 1, ku shpenzimet e aprovuara përfshijnë shpenzimet e kryera, si dhe ato që priten të ndodhin për një periudhë të caktuar kohe që nuk kalon 6 (gjashtë) muaj nga data e raportit të fundit të progresit; dhe ii) në kontekstin e Grantit SDA, raporti i shpenzimeve të pranueshme, për të gjitha aktivitetet, kundrejt totalit të kostos së aprovuar të asistencës teknike të projektit, të specifikuar nën shtojcën 5, ku shpenzimet e aprovuara përfshijnë shpenzimet e kryera, si dhe ato që priten të ndodhin për një periudhë të caktuar kohe që nuk kalon 6 (gjashtë) muaj nga data e raportit të fundit të progresit.

"Norma e referencës" nënkupton EURIBOR për normën e ndryshueshme të interesit të transhit të shprehur në euro.

"Garanci" nënkupton çdo marrëveshje ose masë që krijon një shkallë preferenciale, një të drejtë preferenciale të pagesës, një kolateral ose garanci të çfarëdo natyre, e cila mund të japë të drejta të zgjeruara mbi palët e treta.

"Llogaria speciale" ka kuptimin e përcaktuar në nënklauzolën 4.2.

"Statusi i progresit të punëve" do të thotë: i) në kontekstin e Huas, raporti i shpenzimeve të kryera të aprovuara, për të gjitha pjesët përbërëse të projektit, kundrejt totalit të kostos së aprovuar të Projektit; dhe ii) në kontekstin e Grantit SDA, raporti i shpenzimeve të pranueshme të kryera, për të gjitha aktivitetet e Asistencës Teknike të Projektit, kundrejt kostos totale të AT-së së Projektit.

"Diferenca" do të thotë, në lidhje me normën e ndryshueshme të interesit të transhit, diferencën fikse te Norma e Interesit (që është plus ose minus) e përcaktuar në pikë bazë në Njoftimin e aplikueshëm të Disbursimit.

"Transh" nënkupton, sipas kontekstit, ose "një transh Granti" ose "një transh Huaje".

1.2 Struktura e Marrëveshjes

Përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, referencat për:

a) këtë Marrëveshje do të interpretohen si refe-renca të kësaj Marrëveshjeje, të cilat herë pas here mund të shtohen, ndryshohen ose ripërcaktohen;

b) "Klauzolat", "nënklauzolat" dhe "shpje-gimet" do të interpretohen si referenca të klauzo-lave, nënklauzolave dhe shpjegimeve përkatëse të kësaj Marrëveshjeje; dhe

c) Fjalët e përdorura në njëjës do të përfshijnë shumësin dhe anasjellas.

1.3 Titujt

Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë dome-thënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

2. KUSHTET

Huaja jepet sipas kushteve të përgjithshme të rregullores së Huas dhe kushteve të veçanta të vendosura nga Marrëveshja.

Granti SDA jepet sipas kushteve të veçanta të kësaj Marrëveshjeje.

3. QËLLIMI

3.1 Huaja

CEB-i i jep Huan Huamarrësit, i cili e pranon atë, vetëm me qëllim të financimit të Projektit siç përshkruhet në shtojcën 1 të këtij dokumenti.

Çdo ndryshim në mënyrën si aplikohet huaja që nuk ka marrë miratimin e CEB-it do të përbëjë një ngjarje sipas kushteve të nenit 3.3/h të Rregullores së Huas dhe mund të çojë në pezullimin, anulimin ose rimbursimin para kohe të Huas, sipas dispozitave të nenit 3.3 (Rimbursimet e parakohshme të kredive të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i kredive të papaguara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i kredive të papaguara) të kësaj Rregulloreje.

3.2 Granti SDA

CEB-i i jep Grantin SDA vendit përfitues, i cili e pranon atë, vetëm me qëllim të financimit të Asistencës Teknike të Projektit siç përshkruhet në shtojcën 5 të këtij dokumenti.

Çdo ndryshim në termat dhe kushtet e AT-së së Projektit i komunikohet me shkrim CEB-it në një njoftim paraprak të arsyetuar dhe është subjekt i marrëveshjes paraprake me shkrim nga CEB-i. Nëse ndodh ndonjë ndryshim, që, sipas mendimit të CEB-it, mund të dëmtojë zbatimin e AT-së së Projektit, ose në rast të shkeljes nga vendi përfitues të termave dhe kushteve të AT-së së Projektit, CEB-i rezervon të drejtën e pezullimit, anulimit ose kërkimit të menjëhershëm të shlyerjes së Grantit SDA. Megjithatë, Palët bien dakord që para se të bëhet një pretendim i tillë, do të mbahen konsultime midis tyre.

4. KUSHTET FINANCIARE TË HUAS

4.1 Shuma e Huas

Shuma e Huas është 28,700,000 euro (njëzet e tetë milionë e shtatëqind mijë euro).

4.2 Disbursimi i Huas

Huaja do të disbursohet në transhe.

Shuma e çdo transhi do të përcaktohet në përputhje me statusin e progresit të punëve dhe/ose me statusin e parashikuar të progresit të punëve të projektit. Shuma e Transhit të parë nuk duhet të tejkalojë 50% (pesëdhjetë për qind) të shumës së Huas.

Disbursimet do të kryhen në llogarinë e Projektit.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e Huamarrësit dhe vendit përfitues, nëpërmjet Ministrisë së Financave, do të hapë: i) në Bankën e Shqipërisë, banka qendrore e Shqipërisë, me qendër në Tiranë, një llogari të dedikuar për Projektin dhe AT-në e Projektit në të cilën CEB-i do të transferojë Huan dhe shumat e Grantit SDA (Llogaria e projektit); dhe ii) në një bankë tregtare, një llogari të dedikuar për Projektin dhe asistencën teknike të Projektit në të cilën Ministria e Financave do të transferojë Huan dhe Grantin SDA për t'u përdorur nga NJZP-ja (Llogaria e veçantë). Republika e Shqipërisë nëpërmjet Zyrës së NJZP-së do t'i komunikojë CEB-it detajet e këtyre llogarive pas hapjes së tyre.

4.3 Procedura e disbursimit

Çdo Transh do të disbursohet sipas procedurës së mëposhtme:

Kërkesa e Disbursimit

A. Para çdo disbursimi, pas konsultimit paraprak midis Huamarrësit dhe CEB-i, Huamarrësi do t'i paraqesë CEB-it një kërkesë disbursimi, në formën e përcaktuar konkretisht në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje (më poshtë e referuar si "Kërkesë disbursimi Huaje").

Kërkesa e disbursimit të Huas duhet të përcaktojë si më poshtë:

i) Monedhën dhe shumën e transhit;

ii) Datën e disbursimit; një datë e tillë disbursimi duhet të jetë një ditë pune që bie të paktën 5 (pesë) ditë pune, por jo më vonë se 20 (njëzet) ditë pune pas datës së kërkesës për disbursim të Huas.

iii) Data/datat e shlyerjes së principalit, duke përfshirë datën e maturimit, duke marrë parasysh se periudha e shlyerjes së principalit për secilin transh nuk duhet të tejkalojë 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, përfshirë një periudhë shtyrje afati jo më shumë se 3 (tre) vjet.

iv) Normën fikse maksimale të interesit ose diferencën maksimale të normës së referencës;

v) Periudha e pagesës së interesit dhe datat e pagesës së interesit;

vi) Konventa e përcaktimit të ditëve dhe ditët e punës; dhe

vii) Llogaria e Projektit të Huamarrësit për pagesat.

Çdo kërkesë disbursimi huaje që i dorëzohet CEB-it do të jetë e parevokueshme, nëse nuk është rënë dakord ndryshe me shkrim nga CEB-i.

b) Njoftimi i disbursimit

Nëse CEB-i merr një kërkesë disbursimi huaje që përputhet me kërkesat e parashtruara më sipër në nënklauzolën 4.3/a për kërkesën e disbursimit të Huas, dhe nëse të gjitha kushtet e tjera përkatëse të disbursimit të përcaktuara më poshtë në nënklauzolën 4.5 (Kushtet e disbursimit) janë plotësuar, CEB-i do t'i dorëzojë Huamarrësit një njoftim disbursimi, sipas formës së përcaktuar specifikisht në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje (më poshtë i quajtur "Njoftim disbursimi"). Çdo njoftim disbursimi duhet të dërgohet të paktën 2 (dy) ditë pune para datës së propozuar të disbursimit.

Njoftimi i disbursimit duhet të specifikojë:

viii) Monedhën/monedhat dhe shumat e transhit;

ix) Datën e disbursimit;

x) Periudhën e shlyerjes së principalit dhe datën/datat e shlyerjes, duke përfshirë datën e maturimit;

xi) Normën Fikse të Interesit ose diferencën ndaj normës së referencës;

xii) Periudhën e pagesës së interesit dhe datat e pagesës së interesit;

xiii) Marrëveshjen e përcaktimit të ditëve dhe ditët e punës;

xiv) Llogarinë e Projektit të Huamarrësit dhe llogarinë e CEB-it për pagesat.

Një Njoftim Disbursimi që përkon me elementet e përfshira në një kërkesë disbursimi huaje, përbën një angazhim të parevokueshëm dhe të pakushtëzuar nga ana e Huamarrësit për të marrë hua nga CEB-i dhe nga ana e CEB-it për t'i disbursuar Huamarrësit Transhin sipas termave dhe kushteve të specifikuar në njoftimin e disbursimit.

Pavarësisht nga sa më sipër, nëse CEB-i nuk i dërgon Huamarrësit një njoftim disbursimi brenda 20 (njëzet) ditësh pune pas marrjes së kërkesës për disbursim huaje, kërkesa përkatëse për disbursim huaje do të konsiderohet e anuluar.

4.4 Periudha e Disbursimit

Përveç nëse është rënë dakord ndryshe me shkrim nga CEB-i, Huamarrësi nuk ka të drejtë:

i) të lëshojë një kërkesë disbursimi huaje për Transhin e parë pas 12 (dymbëdhjetë) muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi;

ii) të lëshojë ndonjë kërkesë tjetër disbursimi huaje pas 18 (tetëmbëdhjetë) muajve pas disbursimit të fundit; ose

iii) të lëshojë ndonjë kërkesë tjetër disbursimi huaje pas datës së mbylljes të specifikuar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

4.5 Kushtet e disbursimit

a) Kushtet pararendëse për disbursimin e transhit të parë:

i) Një opinion ligjor në anglisht të lëshuar nga ministri i Drejtësisë që konfirmon sipas kërkesës së CEB-it, dhe sipas modelit konkret të përcaktuar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje, se Marrëveshja është zbatuar në mënyrë të rregullt nga përfaqësuesit e autorizuar të Huamarrësit dhe se ajo është e vlefshme, detyruese dhe në fuqi në përputhje me termat në juridiksionin e Huamarrësit.

ii) Dëshmitë në anglisht sipas kërkesës së CEB-it të personit/personave të autorizuar për të zbatuar Marrëveshjen dhe Kërkesat e Disbursimit në emër të Huamarrësit, së bashku me ekzemplarin e nënshkrimit/eve të këtij personi të certifikuar nga ministri i Financave.

iii) Çdo kusht tjetër të përcaktuar si Kusht i Veçantë në shtojcën 1 (Përshkrimi i Projektit) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Kushtet pararendëse për disbursimin e çdo transhi pasues:

i) Në rast se ka pasur një ndryshim në lidhje me personin/personat e autorizuar për të kryer kërkesën e disbursimit në emër të Huamarrësit, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Financave, do t'i dërgojë CEB-it dëshminë e përditësuar të personit të autorizuar për të kryer kërkesat përkatëse të disbursimit në emër të Huamarrësit, së bashku me ekzemplarin e certifikuar të nënshkrimit të këtij personi;

ii) Raporti i Progresit, në përputhje më kërkesat e CEB-it, që konfirmon alokimin e të paktën 90% (nëntëdhjetë për qind) të transhit të mëparshëm;

iii) Çdo kusht tjetër të përcaktuar si kusht i veçantë në shtojcën 1 (Përshkrimi i projektit) të kësaj Marrëveshjeje.

4.6 Shlyerja

Huamarrësi shlyen principalin e çdo transhi në datën e pagesës së principalit në përputhje me termat e parashtruar në njoftimin e zbatueshëm të disbursimit.

4.7 Shlyerja e parakohshme

a) Mekanizmat e shlyerjes së parakohshme

Në qoftë se sipas ndonjë rasti të specifikuar në këtë Marrëveshje, duke iu referuar kësaj nënklauzole,

Huamarrësit i duhet të rimbursojë para maturimit, të gjithë ose pjesë të një transhi, Huamarrësi duhet t'i japë të paktën 1 (një) muaj para njoftim me shkrim CEB-in (më poshtë i quajtur "Njoftimi i rimbursimit të parakohshëm"), duke specifikuar shumat që do të rimbursohen, datën në të cilën rimbursimi do të bëhet (më poshtë e quajtur "Data e rimbursimit të parakohshëm") dhe, pas konsultimit paraprak me CEB-in në lidhje me shumat, nëse ka, që pritet të dalin në pajtim me nënparagrafin 4.7/b, kostot maksimale të rimbursimit të parakohshëm. Data e RIMBURSIMIt të parakohshëm duhet të përkojë me datën e pagesës së interesit, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe, me shkrim nga CEB-i.

Pas pranimit të njoftimit të rimbursimit të parakohshëm, CEB-i do të dërgojë një njoftim me shkrim për Huamarrësin (këtej e tutje, "Konfirmimi i rimbursimit të parakohshëm"), jo më vonë se 5 ditë pune para datës së rimbursimit, duke treguar interesin e llogaritur për t'u paguar dhe kostot e rimbursimit të parakohshëm në pajtim me nënklauzolën 4.7/b.

Konfirmimi i rimbursimit të parakohshëm që plotëson të gjitha elementet e përfshira në një njoftim rimbursimi të parakohshëm përbën një angazhim të parevokueshëm dhe të pakushtëzuar nga ana e Huamarrësit për rimbursimin e shumave përkatëse të CEB-it, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në konfirmimin e rimbursimit të parakohshëm. Nëse Huamarrësi rimburson pjesërisht një transh, shuma e rimbursuar do të aplikohet proporcionalisht për çdo shlyerje të prapambetur principali. Në një rast të tillë, konfirmimi i rimbursimit të parakohshëm do të përfshijë edhe planin e përshtatur të shlyerjeve, i cili është detyrues për Huamarrësin.

b) Kostot e rimbursimit të parakohshëm

Kostot e rimbursimit të parakohshëm që rezultojnë nga rimbursimi i parakohshëm në përputhje me nënklauzolën 4.7/a përcaktohen nga CEB-i në bazë të kostove të rishpërndarjes së shumës që do të rimbursohet nga Data e rimbursimit të parakohshëm në datën e maturimit, duke përfshirë edhe ndonjë kosto përkatëse, të tilla si kosto për zgjidhjen e çdo dispozite themelore mbrojtëse që lidhet me të. Kostot e rishpërndarjes do të krijohen mbi bazën e diferencës ndërmjet normës fillestare dhe normës së rishpërndarjes, e cila do të përcaktohet nga CEB-i në bazë të kushteve të tregut, në datën e njoftimit të rimbursimit të parakohshëm.

4.8 Përcaktimi i interesit

Huamarrësi do të paguajë herë pas here interesin mbi principalin e çdo transhi gjatë çdo periudhe interesi, sipas normës fikse ose të ndryshueshme të Interesit të specifikuar në njoftimin e zbatueshëm të disbursimit.

Interesi llogaritet i) duke filluar nga dhe duke përfshirë ditën e parë të periudhës së interesit, por duke përjashtuar ditën e fundit të kësaj periudhe interesi; dhe ii) është i detyrueshëm dhe i pagueshëm në datat e pagesës së interesit të përcaktuara në njoftimin e aplikueshëm të disbursimit. interesi do të llogaritet në bazë të marrëveshjes së përcaktimit të ditës, e specifikuar në njoftimin përkatës të disbursimit.

Në rastin e normës së interesit të ndryshueshëm të transheve, CEB-i përcakton për secilën datë të përcaktimit të interesit normën e zbatueshme të interesit gjatë periudhës përkatëse të interesit, në përputhje me Marrëveshjen dhe menjëherë e njofton për këtë Huamarrësin. Çdo përcaktim nga CEB-i është përfundimtar, vendimtar dhe detyrues për Huamarrësin, përveç nëse i provohet CEB-it nga Huamarrësi, që një përcaktim i tillë është një gabim i qartë.

4.9 Norma e interesit të papaguar

Në rast se Huamarrësi nuk arrin të paguajë, tërësisht ose pjesërisht, çdo shumë sipas Marrëveshjes, dhe pavarësisht çdo mjeti tjetër të disponueshëm nga CEB-i sipas Marrëveshjes, Huamarrësi do të paguajë interes mbi shumat e papaguara nga data e pagesës deri në datën e marrjes së një pagese të tillë nga CEB-i në normën e interesit vjetor të barabartë me EURIBOR-in njëmujor, të kuotuar në datën e caktuar të pagesës plus dyqind e pesëdhjetë pikë bazë (250 pikë bazë) (më poshtë e quajtur "Norma e interesit të papaguar").

Norma e zbatueshme e interesit të papaguar do të përditësohet çdo 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.

4.10 Ngjarja e deformimit të tregut

CEB-i, pas marrjes së informacionit që ka ndodhur një rast deformimi tregu, e njofton menjëherë Huamarrësin në lidhje me këtë.

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, "Rasti i deformimit të tregut" u referohet rrethanave të mëposhtme:

a) Faqja "Reuter" e referuar në përkufizimin e EURIBOR-it nuk jep të dhënat e kërkuara ose nuk

është e arritshme.

b) Sipas një ngjarjeje të tillë të deformimit të tregut, EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë norma e përqindjes në vit, e përcaktuar nga CEB-i si mesatarja aritmetike e normave në të cilat kreditë në euro, në një shumë të njëjtë apo të afërt të krahasueshme me shumën e kredisë në fjalë dhe për një periudhë të njëjtë ose më të përafërt të krahasueshme me periudhën përkatëse të interesit, janë dhënë nga 3 (tri) banka kryesore në tregun ndërbankar të BE-së të zgjedhur nga CEB-i, në ditën e përcaktimit të Normës së Interesit. Nëse janë siguruar të paktën 2 (dy) kuotime, EURIBOR-i i zbatueshëm për atë Datë përcaktimi interesi do të jetë mesatarja aritmetike e të gjitha kuotimeve të ofruara.

c) Nëse është ofruar vetëm 1 (një) kuotim, EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë norma e përqindjes në vit e përcaktuar nga CEB-i si mesatarja aritmetike e normave në të cilat kreditë në euro, në një shumë të njëjtë apo të afërt të krahasueshme me shumën e kredisë në fjalë dhe për një periudhë të njëjtë apo të afërt të krahasueshme me periudhën përkatëse të interesit, janë dhëna nga bankat kryesore në tregun ndërbankar të BE-së të zgjedhur nga CEB-i, në ditën e dytë të punës pas fillimit të periudhës përkatëse të interesit.

d) CEB-i vendos se nuk është e mundur të përcaktohet norma e referencës së aplikueshme në përputhje me paragrafin e mësipërm "a".

e) Sipas një rasti të tillë deformimi të tregut, norma e interesit të ndryshueshëm do të zëvendësohet me normën që shpreh si një normë përqindjeje në vit koston e financimit të Huas së CEB-it nga çfarëdolloj burimi të cilin CEB-i e çmon të arsyeshëm për t'u zgjedhur.

f) Në çdo kohë ndërmjet dorëzimit të njoftimit të disbursimit dhe datës së disbursimit, CEB-i konstaton në mënyrë të arsyeshme se ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme dhe raste të paparashikura të një natyre ekonomike, financiare, politike apo aspekti tjetër të jashtëm që ndikojnë negativisht në aksesin e CEB-it në burimet e tij të financimit.

g) Në një rast të tillë deformimi tregu, CEB-i ka të drejtë ta anulojë disbursimin e planifikuar pa mbartur asnjë detyrim.

Në rastet e deformimit të tregut të përcaktuara në pikat "a" dhe "b" më sipër:

i) nëse huamarrësi e kërkon, palët, duke vepruar në mirëbesim, do të hyjnë në negociata për një periudhë jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, në mënyrë që të bien dakord mbi një alternativë për EURIBOR-in e aplikueshëm. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje, Huamarrësi mund të vazhdojë me rimbursimin e parakohshëm në datën e pagesës së interesit të radhës sipas kushteve të përcaktuara në nënklauzolën 4.7;

ii) CEB-i ka të drejtë, duke vepruar në mirëbesim dhe në konsultim me Huamarrësin derisa të jetë e mundur, të ndryshojë kohëzgjatjen e çdo periudhë pasardhëse interesi deri në 30 (tridhjetë) ditë kalendarike ose më pak, duke i dërguar Huamarrësit një njoftim për këtë qëllim. Çdo ndryshim i tillë në një periudhë interesi hyn në fuqi në datën e specifikuar në njoftim nga CEB-i.

Nëse CEB-i vendos se rasti i deformimit të tregut nuk ekziston më, atëherë norma e ndryshueshme dhe periudha e interesit e zbatueshme për transhin përkatës që i janë nënshtruar për arsye të ndonjë rasti të ndodhur ose ekzistues të mosfunksionimit të tregut, do të kthehen, që nga dita e parë e periudhës pasardhëse të interesit, te llogaritja në përputhje me normën e ndryshueshme të interesit dhe periudhën e interesit të specifikuar në njoftimin përkatës të disbursimit.

4.11 Pagesat

Të gjitha shumat e detyrueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje janë të pagueshme në monedhën e secilit transh në llogarinë e CEB-it, të përcaktuar në njoftimin e aplikueshëm të disbursimit. Çdo pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në ditën e punës, që i nënshtrohet Konventës së Ditës së Punës pasardhëse të modifikuar. Çdo pagesë do të konsiderohet e kryer pasi CEB-i të ketë marrë shumën në llogari të tij.

Huamarrësi ose banka e udhëzuar nga Huamarrësi, sipas rastit, i dërgon CEB-it një njoftim pagese me shkrim të paktën 5 (pesë) ditë pune para pagesës së çfarëdo shume të detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

5. KUSHTET FINANCIARE TË GRANTIT SDA

5.1 Shuma e Grantit SDA

CEB-i sipas mënyrës së referuar në paragrafin 5.2 më poshtë, do t'i mundësojë vendit përfitues Grantin SDA në shumën maksimale prej 1,000,000 eurosh (një milion euro).

5.2 Disbursimet e Grantit SDA

Në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha kushtet pararendëse për disbursimin në lidhje me: a) transhin e parë siç përcaktohet në nënparagrafët 4.5/a(i) dhe 4.5/a(ii) (Kushtet pararendëse për disbursimin e transhit të parë) dhe Republika e Shqipërisë, nëpërmjet NJZP-së t'i ketë komunikuar CEB-it detajet e llogarisë së projektit dhe llogarisë së veçantë; dhe b) çdo transh pasues siç përcaktohet në nënparagrafët 4.5/b(i) dhe 4.5/b(ii) (Kushtet pararendëse për disbursimin e çdo transhi pasardhës), sipas rastit, të jenë përmbushur, dhe të ketë marrë një kërkesë të plotësuar siç duhet dhe të nënshkruar për disbursimin e Transhit të Grantit SDA nga vendi përfitues, sipas modelit konkret të parashtruar në shtojcën 6 të kësaj Marrëveshjeje (Kërkesë disbursimi për Grantin SDA (model)) këtu do të referohet si Kërkesë disbursimi për Grantin SDA, CEB-i do të disbursojë shumën e Grantit SDA në një minimum prej 2 (dy) transhesh.

Shuma e parë e transhit të Grantit nuk duhet të tejkalojë 20% (njëzet për qind) të shumës së Grantit SDA.

Shuma e secilit transh të Grantit do të caktohet sipas statusit të ecurisë së punimeve dhe ose statusit të parashikuar të ecurisë së AT-së së Projektit.

Disbursimi i çdo transhi pasardhës do t'i nënshtrohet një raporti progresi, i cili i konfirmon CEB-it alokimin e të paktën 90% të transhit të mëparshëm të Grantit.

Disbursimet do të kryhen në llogarinë e Projektit.

Granti SD do të paguhet në euro (EUR). Të gjitha llogaritë dhe pasqyrat financiare do të shprehen në euro në raportimet me CEB-in.

5.3 Periudha e disbursimit

Përveç nëse është rënë dakord ndryshe me shkrim nga CEB-i, vendi përfitues nuk ka të drejtë të lëshojë një kërkesë disbursimi granti SDA pas datës së përfundimit të specifikuar në shtojcën 5 të kësaj Marrëveshjeje.

5.4 Shlyerja

Çdo fond i mbetur i pashpenzuar në datën e përfundimit apo ndonjë shlyerje e Grantit të SDA-së, në përputhje me këtë Marrëveshje, do t'i kthehet CEB-it në euro, nëse nuk është rënë dakord ndryshe ndërmjet palëve.

6. ZBATIMI I PROJEKTIT

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e Huamarrësit, do të zbatojë Projektin dhe në cilësinë e vendit përfitues, do të zbatojë AT-në e Projektit në përputhje me Marrëveshjen.

Republika e Shqipërisë ka caktuar Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) si NJZP. Republika e Shqipërisë garanton që NJZP-ja ka personelin e përshtatshëm dhe pajisjet e duhura gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit.

Në çdo rast, Republika e Shqipërisë, në cilësinë e Huamarrësit dhe vendit përfitues, mbetet përgjegjësi i vetëm për të përmbushur detyrimet e tij sipas Marrëveshjes.

Pamundësia për të përmbushur angazhimet e zbatimit në lidhje me Projektin e përcaktuar sipas kësaj klauzole nr. 6, do të përbënte, pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të zbatueshme të Rregullores së Huas, një ngjarje sipas kushteve të nenit 3.3/h të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë që: i) shpenzimet përkatëse të kontratës të deklarohen të papërshtatshme për alokim në kuadër të Projektit; dhe/ose ii) rimbursimin e parakohshëm, pezullimin ose anulimin e Huas, në tërësi ose pjesërisht, sipas kushteve të neneve 3.3 (Rimbursimi i parakohshëm i kredive të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i kredive të padisbursuara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i kredive të padisbursuara) të Rregullores së Huas.

Në rast të mospërmbushjes së angazhimeve të zbatimit të projektit në lidhje me AT-në e Projektit të përcaktuar në bazë të kësaj klauzole nr. 6, CEB-i rezervon të drejtën të pezullojë, anulojë ose kërkojë shlyerjen e menjëhershme të Grantit SDA. Para se të bëhet një pretendim i tillë, duhet të zhvillohen konsultime ndërmjet Palëve.

6.1 Përgjegjësia morale

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, nëpërmjet NJZP-së aplikon të gjithë kujdesin dhe angazhimin e duhur, dhe ushtron të gjitha mjetet e përdorura zakonisht (përfshirë këtu, por jo duke u kufizua,r në mjete ligjore, financiare, menaxheriale dhe teknike) të nevojshme për zbatimin e duhur të AT-së së Projektit dhe Projektit.

6.2 Periudha e alokimit

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e Huamarrësit, do të alokojë çdo Transh Huaje, brenda 12

(dymbëdhjetë) muajve pas datës përkatëse të disbursimit dhe në cilësinë e vendit përfitues, duhet të ndajë çdo Transh Granti brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve pas datës së disbursimit përkatës (secila referohet si "Periudha e alokimit").

Nëse një Transh Huaje i disbursuar nga CEB-i nuk është alokuar apo është alokuar vetëm pjesërisht brenda periudhës së alokimit, Huamarrësi do t'i rimbursojë shumat e paalokuara CEB-it, në pajtim me nënklauzolën 4.7, përveç nëse, pas marrjes së një kërkese të arsyetuar siç duhet për një zgjatje periudhe alokimi nga Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Financave, CEB-i bie dakord të zgjasë periudhën e alokimit.

Nëse një Transh Granti i disbursuar nga CEB-i nuk është alokuar apo është alokuar vetëm pjesërisht brenda periudhës së alokimit, vendi përfitues do t'i rimbursojë shumat e paalokuara CEB-it në pajtim me nënklauzolën 5.4, përveç nëse, pas marrjes së një kërkese të arsyetuar siç duhet për një zgjatje periudhe alokimi nga vendi përfitues nëpërmjet Ministrisë së Financave, CEB-i bie dakord të zgjasë periudhën e alokimit.

6.3 Kostot e Projektit

Transhet e disbursuara në kuadër të Huas nuk duhet të kalojnë shtatëdhjetë e tetë pikë dy përqindëshin (78.2%) e kostos së përgjithshme të pranuar të Projektit dhe Transhet e disbursuara në kuadër të Grantit SDA nuk duhet të kalojnë njëqindpërqindëshin (100%) e kostos së përgjithshme të pranuar të AT-së së Projektit dhe për të shmangur paqartësitë kufizohen në shumën e Huas, të specifikuar në nenin 4.1 dhe në shumën e Grantit SDA të specifikuar në nenin 5.1 të kësaj Marrëveshjeje.

Nëse shpenzimet e aprovuara totale të AT-së së Projektit, Projektit ose të të dyjave, sipas rastit, rriten apo rishikohen, për çfarëdo arsye, Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe të Huamarrësit, do të sigurojë që burimet shtesë financiare për përfundimin e AT-së së Projektit apo të Projektit, ose të të dyve, sipas rastit, janë të disponueshme pa ndonjë rekurs ndaj CEB-it. Planet për të financuar rritjen e shpenzimeve do t'i komunikohen CEB-it pa vonesë.

6.4 Angazhimet Specifike të Projektit

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, do të garantojë që:

i) i gjithë trualli, të drejtat e pasurisë së patundshme dhe lejet e nevojshme për zbatimin e projektit janë të disponueshme në kohën e duhur;

ii) të gjitha asetet dhe makineritë në kuadër të Projektit janë të siguruara në mënyrë të përhershme dhe mirëmbahen në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare; dhe

iii) çdo kërkesë tjetër e specifikuar si kusht specifik në shtojcat 1 (Përshkrimi i Projektit) dhe 5 (Përshkrimi i AT-së së Projektit) zbatohet në përputhje me këtë marrëveshje.

6.5 Prokurimi

Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve që do të financohen në bazë të AT-së së Projektit dhe Projektit, do të realizohet në përputhje me Udhëzimet e Prokurimit të CEB-it. Me zgjedhje të CEB-it, do të përdoren edhe dokumentet e harmonizuara kryesore të prokurimit të miratuara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, kontrata e FIDIC-it dhe modelet.

Pragjet mbi të cilat do t'i kërkohet Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, për të marrë furnizimet, punimet dhe shërbimet përmes procedurave ndërkombëtare të prokurimit, janë ato të aplikueshmet nën direktivat e prokurimit përkatës të BE-së, të përditësuara herë pas here dhe të botuara në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (OJEU).

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

"Direktivat e prokurimit të BE-së" u referohen: i) Direktivës 2014/25/BE së Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 26 shkurt 2014, për prokurimet nga subjektet që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/BE; dhe/ose ii) Direktivës 2014/24/BE e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, të datës 26 shkurt 2014, mbi prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/BE, të ndryshuar herë pas here.

Plani i prokurimit (si term i tillë është përcaktuar në bazë të udhëzimeve të prokurimit) (dhe çdo përditësim i tyre) që tregon metodat e prokurimit për secilën kontratë do të dorëzohet nga NJZP-je (në emër të Huamarrësit) për miratim te CEB-i. Pas marrjes së këtij plani, CEB-i informon NJZP-në (në emër të Huamarrësit), me një kopje për Huamarrësin, lidhur me aspektet e shqyrtimit që CEB-i do të kryejë për çdo kontratë.

6.6 Mjedisi

Huamarrësi do të zbatojë Projektin në përputhje me kërkesat e përcaktuara në politikat mjedisore.

6.7 Të drejtat e njeriut

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, garanton që zbatimi i AT-së së Projektit dhe Projekti do të respektojë: i) Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe ii) Kartën Sociale Evropiane.

6.8 Integriteti

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, angazhohet që ajo apo ndonjë person tjetër, me pëlqimin apo dijeninë e saj paraprake, nuk do të kryejnë, në lidhje me zbatimin e AT-së së Projektit, të Projektit ose me zbatimin e çdo kontrate në kuadër të AT-së së Projektit ose Projektit, praktika korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehta (më poshtë të referuara bashkërisht si "Praktikat e ndaluara").

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

i) një "Praktikë e korruptuar" nënkupton ofrimin, dhënien, marrjen apo kërkimin, drejtpërdrejt apo tërthorazi, të ndonjë gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të parregullt mbi veprimet e një pale tjetër;

ii) një "Praktikë mashtruese" do të thotë çdo veprim ose harresë, duke përfshirë një keqinterpretim, që me dashje apo për neglizhencë çorienton apo tenton të çorientojë, një palë për të marrë një përfitim financiar ose përfitim tjetër, ose për të shmangur një detyrim;

iii) një "Praktikë shtrënguese" do të thotë cenim ose dëmtim, apo kërcënimi për të cenuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë palë apo pronën e palës për të ndikuar në mënyrë të parregullt veprimet e një pale;

iv) një "Praktikë e Marrëveshjes së fshehtë" është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve e bërë për të arritur një qëllim të padrejtë, përfshirë ndikimin e padrejtë ndaj vendimeve të një pale tjetër.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, merr përsipër të informojë CEB-in nëse ajo vihet në dijeni për çdo fakt ose informacion që tregon kryerjen e ndonjë praktike të tillë të ndaluar. Për këtë qëllim, edhe njohuritë e çdo anëtari të NJZP-së do të konsiderohen si njohuritë e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, angazhohet:

i) të ndërmarrë veprime në kohën e duhur, sipas kërkesës së arsyetuar të CEB-it, për të hetuar dhe/ose ndërprerë çdo praktikë të ndaluar të dyshuar ose të pretenduar si e tillë;

ii) të informojë CEB-in mbi masat e marra për të kërkuar dëmshpërblim nga personat përgjegjës për çdo humbje të rezultuar nga ndonjë praktikë e tillë e ndaluar; dhe

iii) të lehtësojë çdo hetim që CEB-i mund të bëjë në lidhje me ndonjë akt të tillë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është përgjegjës për komunikimin me CEB-in, për qëllimet e kësaj nënklauzole.

6.9 Vizibiliteti

Huaja. Huamarrësi do të informojë përfituesit përfundimtarë, që Projekti financohet pjesërisht nga CEB, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme të komunikimit, të tilla si: njoftimeve të dedikuara në faqet përkatëse të internetit, komunikatave për shtyp, broshurave apo ekspozimit të tabelave/pllakateve në sitet ose objektet përkatëse të Projektit. Në çdo rast, informacioni i dhënë për përfituesit përfundimtarë do të prezantojë në mënyrë të përshtatshme emrin dhe logon e CEB-it.

Granti SDA. Vendi përfitues do të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar se kontratat e shërbimit dhe dokumentet e prodhuara në kuadër të aktiviteteve, financuar nëpërmjet Grantit SDA do të bëjnë gjithmonë të ditur dhe publike që aktivitetet janë financuar nga SDA përmes CEB-it.

Publikimet që kanë të bëjnë me Projektin ose AT-në e Projektit, në çfarëdolloj forme dhe mjeti, duke përfshirë edhe internetin: i) do të mbajnë dukshëm logon e CEB-it; dhe ii) do të pasqyrojnë një shënim si më poshtë ose të ngjashme me të: "Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument mund të mos reflektojnë gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës".

7. MONITORIMI

7.1 Raportimi

a) Raportet e progresit

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, nëpërmjet NJZP-së, do t'i dërgojë CEB-it një raport progresi (më poshtë i quajtur "Raporti i progresit") në bazë gjashtëmujore dhe para çdo Kërkesë Disbursimi, me përjashtim të Transhit të parë.

Shtojca 4 e këtij dokumenti ofron një model i cili përcakton informacionin minimal që kërkohet nga

CEB-i. Gjithashtu, mund të përdoren edhe formate alternative që përmbajnë të njëjtin informacion.

b) Raporti përfundimtar

Pas përfundimit të Projektit/alokimit të plotë të transheve, Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, nëpërmjet NJZP-së, duhet të paraqesë një raport përfundimtar (më poshtë i quajtur "Raporti përfundimtar") duke përfshirë një vlerësim të ndikimit social të Projektit.

Raporti përfundimtar do të përfshijë një vlerësim të përdorimit dhe të ndikimit të Grantit SDA. Raporti i Përfundimit duhet të konsiderohet i pranueshëm nga CEB-i.

7.2 Vizitat

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, merr përsipër të presë me gatishmëri çdo vizitë monitorimi / teknike / vlerësimi, duke përfshirë edhe lehtësimin e aksesit në vendndodhjet e Projektit apo të kontraktuesve përkatës, të kryera nga anëtarët e stafit të CEB-it ose palëve të treta të përcaktuara.

7.3 Auditimi

Republika e Shqipërisë merr përsipër t'i ofrojë CEB-it, në bazë vjetore, një opinion të auditimit të llogarisë speciale të kryer nga një audit i jashtëm. Një auditues i tillë i jashtëm duhet të ketë qenë i kontraktuar nga Ministria e Financave. Nëse kostot e auditimit financohen me të ardhurat e Huas ose të Grantit SDA, Republika e Shqipërisë angazhohet që të kontraktojë një auditues të jashtëm në përputhje me udhëzimet e prokurimit të CEB-it.

Nëse Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, nuk arrin të kryejë ndonjë nga angazhimet e saj sipas Marrëveshjes, Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, angazhohet të presë siç duhet, çdo vizitë auditimi në terren, të ndërmarrë nga anëtarët e stafit të CEB-it ose palët e treta të caktuara, shpenzimet e të cilave do të mbulohen nga Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe/ose të Huamarrësit, sipas rastit.

7.4 Informacioni lidhur me Projektin

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe të Huamarrësit, nëpërmjet NJZP-së, do të mbajë regjistra llogarie, në lidhje me: i) AT-në e Projektit; dhe ii) Projektin, të cilat do të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke treguar, në çdo periudhë kohore, gjendjen e progresit të Asistencës Teknike të Projektit dhe Projektit, dhe që do të regjistrojnë të gjitha veprimet e bëra dhe të identifikojnë asetet dhe shërbimet e financuara ose të financuara pjesërisht, sipas rastit, nëpërmjet: i) Grantit SDA; dhe ii) Huas.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe të Huamarrësit, nëpërmjet NJZP-së, do t'i dorëzojë CEB-it në kohën e duhur, çdo informacion apo dokument lidhur me financimin ose zbatimin (duke përfshirë në veçanti çështjet e prokurimit dhe ato të mjedisit) e AT-së së Projektit dhe të Projektit, sipas kërkesës së CEB-it.

Republika e Shqipërisë, në cilësinë e vendit përfitues dhe Huamarrësit, nëpërmjet NJZP-së, informon CEB-in, menjëherë, për çdo ngjarje që mund të ketë ndikim të rëndësishëm negativ në zbatimin e asistencës teknike të Projektit apo të Projektit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

i) çdo veprim ose protestë të iniciuar ose një kundërshtim të ngritur nga palët e treta ose ndonjë ankesë e mirëfilltë e marrë nga Huamarrësi ose ndonjë çështje gjyqësore e rëndësishme që është filluar apo rrezikon të fillojë në lidhje me prokurimin ose çështjet mjedisore apo çështje të tjera që ndikojnë në asistencën teknike të Projektit ose në Projekt; dhe

ii) çdo dekretim të ose çdo amendament të çdo ligji, vendimi ose rregulloreje (ose në zbatimin apo interpretimin zyrtar të ndonjë ligji, vendimi ose rregulloreje).

Çdo ngjarje që mund të ketë ndikim të rëndësishëm negativ në zbatimin e projektit përbën një ngjarje sipas nenit 3.3/h të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë rimbursimin e parakohshëm, pezullimin ose anulimin e Huas sipas kushteve të neneve 3.3 (Rimbursimi i parakohshëm i Huave të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i Huave të padisbursuara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i Huave të padisbursuara) të Rregullores së Huas.

Në rast të shfaqjes së një ndikimi të rëndësishëm negativ në zbatimin e asistencës teknike të Projektit, CEB-i rezervon të drejtën të pezullojë, anulojë ose kërkojë shlyerjen e menjëhershme të Grantit SDA; para se të bëhet një pretendim i tillë duhet të zhvillohen konsultime ndërmjet Palëve.

7.5 Informacioni lidhur me Huamarrësin

Huamarrësi informon CEB-in menjëherë në lidhje me çfarëdolloj ndryshimi thelbësor të pafavorshëm. Çdo lloj ndryshimi thelbësor i pafavorshëm përbën një ngjarje sipas kushteve të nenit 3.3/h të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë një rimbursimim të parakohshëm, pezullim ose

anulim të Huas sipas kushteve të neneve 3.3 (Rimbursimi i parakohshëm i Huave të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i Huave të padisbursuara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i Huave të padisbursuara) të Rregullores së Huas.

Përgjithësimi i mosplotësimit të angazhimeve

Pas një rasti mosplotësimi detyrimesh, Huamarrësit i kërkohet apo mund t'i kërkohet, pas mbarimit të një periudhe kontraktuale pa pagim interesi, të parapaguajë, të shlyejë apo të mbyllë përpara maturimit çdo instrument borxhi afatgjatë ose afatshkurtër ose çdo angazhim tjetër në lidhje me ndonjë instrument borxhi pezullohet ose anulohet, duke përbërë një ngjarje sipas kushteve të nenit 3.3/h të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të Huas, sipas kushteve të nenit 3.3 (Rimbursimi i parakohshëm i Huave të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i Huave të padisbursuara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i Huave të padisbursuara).

8. PARI PASSU

Pamundësia për të zbatuar dispozitat e përcaktuara në këtë marrëveshje në klauzolën 8 do të përbënte një ngjarje sipas kushteve të nenit 3.3/h të Rregullores së Huas dhe mund të sjellë Rimbursimin e Parakohshëm, pezullimin ose anulimin e Huas sipas kushteve të neneve 3.3 (Rimbursimi i Parakohshëm i Huave të Disbursuara), 3.5 Pezullimi nga Banka i Huave të Padisbursuara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i Huave të Padisbursuara).

8.1 Klasifikimi

Huamarrësi do të sigurojë që detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje, të klasifikohen dhe do të klasifikohen jo më pak se *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e pasiguruara dhe të parenditura aktuale dhe të ardhshme sipas instrumenteve të borxhit.

Në veçanti, Huamarrësi nuk do të bëjë (ose autorizojë) ndonjë pagesë në lidhje me Instrumentin e borxhit (i planifikuar rregullisht ose ndryshe), nëse:

i) CEB-i bën një kërkesë rimbursimi të parakohshme sipas nenit 3.3 të Rregullores së Huas; ose

ii) ndonjë ngjarje ose rast potencial mosplotësimi detyrimesh sipas instrumentit të borxhit të pasiguruar dhe të nënrenditur të Huamarrësit ose të ndonjë prej agjencive apo instrumenteve ka ndodhur dhe vazhdon akoma.

Megjithatë, pagesa në lidhje me një instrument të tillë borxhi është e mundur nëse Huamarrësi:

i) paguan njëkohësisht; ose

ii) vendos në një llogari të caktuar për pagesën në datën e ardhshme të pagesës së interesit, një shumë të barabartë me të njëjtën pjesë të principalit të mbetur sipas kësaj Marrëveshjeje, që pjesa e pagesës sipas instrumentit të borxhit ka ndaj totalit të borxhit të mbetur sipas atij instrumenti.

Për këtë qëllim, nuk do të merret parasysh asnjë pagesë e instrumentit të borxhit që është bërë jashtë të ardhurave të emetimit të një instrumenti tjetër për të cilin kanë nënshkruar kryesisht të njëjtët persona me pretendime sipas instrumentit të borxhit.

8.2 Garancia

Nëse Huamarrësi i jep një pale të tretë garanci për realizimin e një instrumenti të borxhit, Huamarrësi duhet të njoftojë CEB-in në kohë për qëllimet e tij, dhe nëse ia kërkon CEB-it, t'i ofrojë CEB-it brenda afateve të përcaktuara në njoftimin e CEB-it, garanci të njëjtë ose të barasvlershme për kryerjen e detyrimeve financiare sipas kësaj Marrëveshjeje.

Kjo dispozitë nuk do të zbatohet, për një garanci:

a) të krijuar mbi pronën në kohën e blerjes vetëm si siguri për pagesën e çmimit të blerjes ose për pagesën e borxhit të shkaktuar me qëllim financimin e blerjes së një pronë së tillë;

b) të krijuar në rrjedhën e zakonshme të transaksioneve bankare dhe sigurimin e maturimit të një instrumenti borxhi, jo më shumë se 1 (një) vit pas datës në të cilën është shkaktuar fillimisht; ose

c) të miratuar më parë nga CEB-i.

8.3 Klauzolat e përfshirjes

Nëse ndonjë instrument borxhi afatmesëm ose afatgjatë i Huamarrësit përfshin dispozita lidhur me rënien në klasifikim, raporte financiare ose *pari passu* që janë më rigorozë sesa dispozitat e barasvlershme të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të njoftojë për këtë CEB-in, dhe me kërkesën e CEB-it, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, do të hartojë brenda periudhës së përcaktuar në njoftimin e CEB-it, një amendament të kësaj Marrëveshjeje për të parashikuar një dispozitë të barasvlershme në favor të CEB-it.

8.4 Parapagimi ndaj Palëve të Treta

Nëse Huamarrësit i duhet të parapaguajë në tërësi ose pjesërisht, vullnetarisht ose ndryshe, ndonjë instrument borxhi afatgjatë ose afatmesëm, duhet të njoftojnë CEB-in për këtë.

Në një rast të tillë dhe me kërkesë të CEB-it, Huamarrësi do t'i rimbursojë CEB-it shumat e disbursuara në kuadër të Huas, në përputhje me nënklauzolën 4.7, në një përpjesëtim të tillë sa është shuma e parapaguar e Instrumentit përkatës të Borxhit. Ajo çfarë është përmendur më sipër nuk lidhet me parapagesat e shumave të kredive të rinovueshme automatikisht, të cilat mbeten të hapura për t'u tërhequr mbi të njëjtat kushte pas një parapagimi të tillë.

Për qëllimet e Marrëveshjes, "Parapagimi" nënkupton shlyerjen e parakohshme të maturimit.

9. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton, që:

a) autoritetet e tij kompetente e kanë autorizuar të hyjë në këtë Marrëveshje dhe kanë dhënë autorizimin nënshkrues për këtë qëllim, në përputhje me ligjet, dekretet, rregulloret, nenet dhe tekstet e tjera të zbatueshme për të;

b) ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e detyrimeve të tij sipas pajtueshmërisë me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, nuk do të:

i) shkelë apo nuk do të jetë në kundërshtim me ndonjë ligj të zbatueshëm, statut, rregull apo rregullore ose ndonjë gjykim, dekret apo leje së cilës i nënshtrohet;

ii) shkelë apo nuk do të jetë në kundërshtim me ndonjë marrëveshje apo instrument tjetër borxhi, për të cilin mund të pritet të ketë ndikim thelbësor të pafavorshëm;

c) nuk ka asnjë ngjarje apo rrethanë të pazgjidhur e cila përbën një mosplotësim detyrimesh sipas çdo marrëveshjeje tjetër ose instrumenti borxhi, i cili është detyrues ose asetet e tij i nënshtrohen, dhe që pritet të shkaktojnë një ndryshim negativ thelbësor.

d) Asnjë garanci nuk i është dhënë palëve të treta në shkelje të nënklauzolës 8.2;

e) (Në dijeninë dhe besimin e tij) nuk ka asnjë çështje gjyqësore, arbitrazh, procedim adminis-trativ në çfarëdolloj gjykate, agjenci ose gjykatë arbitrazhi, e cila ka filluar ose rrezikon të fillojë kundër tij si dhe e cila pritet të shkaktojë ndryshim thelbësor të pafavorshëm.

f) ai ka marrë një kopje të rregullores së Huas, politikat e huas, politikat mjedisore dhe udhëzimet e prokurimit dhe i ka shqyrtuar ato.

Përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme konsiderohen të përsëritura në datën e nënshkrimit të çdo kërkese disbursimi. Çdo ndryshim në lidhje me përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme duhet, për të gjithë periudhën e Huas, t'i komunikohet menjëherë CEB-it dhe t'i mundësohen të gjitha dokumentet mbështetëse.

Nëse ndonjë nga përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme është ose vërtetohet se ka qenë i pasaktë ose çorientues në çdo aspekt, kjo do të përbënte një ngjarje sipas kushteve të nenit 3.3/h të Rregullores së Huas dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të Huas sipas kushteve të neneve 3. 3 (Rimbursimi i parakohshëm i Huave të disbursuara), 3.5 (Pezullimi nga Banka i Huave të padisbursuara) dhe 3.6 (Anulimi nga Banka i Huave të padisbursuara) të rregullores së Huas.

10. PALËT E TRETA

Huamarrësi mund të mos ngrejë ndonjë fakt që ka lidhje brenda objektit të përdorimit të Huas, me marrëdhëniet e tij me palët e treta, me qëllim që të shmangë përmbushjen, tërësisht ose pjesërisht, të detyrimeve që lindin nga Marrë-veshja.

CEB-i mund të mos përfshihet në mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Huamarrësit dhe palëve të treta dhe kostot e çfarëdolloj natyre, të shkaktuara nga CEB-i mbi bazë të ndonjë pretendimi dhe në veçanti, të gjitha kostot ligjore ose gjyqësore, do të përballohen nga Huamarrësi.

11. HEQJA DORË NGA NJË E DREJTË

Në asnjë rast, duke përfshirë vonesat ose ushtrimin e pjesshëm, nuk do të mund të prezumohet që CEB-i ka hequr dorë në mënyrë të heshtur nga ndonjë e drejtë e dhënë atij nga Marrëveshja.

12. DETYRA

Huamarrësi nuk mund të caktojë apo të transferojë ndonjë prej të drejtave apo detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, pa miratimin paraprak me shkrim të CEB-it.

CEB-i mund të caktojë të gjitha ose pjesë të të drejtave dhe përfitimeve të tij apo të transferojë tërësisht apo pjesërisht të drejtat, përfitimet apo detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje.

13. LIGJI I ZBATUESHËM

Marrëveshja do të drejtohet nga rregullat e CEB-it siç specifikohet në dispozitat e nenit 1, paragrafi 3, të Protokollit të Tretë (të datës 6 mars 1959) të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe

Imunitetet e Këshillit të Evropës (datë 2 shtator 1949) dhe së dyti, nëse është e nevojshme, nga ligji francez.

14. MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve në Marrëveshje i nënshtrohen arbitrazhit sipas kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të Rregullores së Huas.

Palët bien dakord për të mos përfituar nga asnjë privilegj, imunitet apo legjislacion para një autoriteti juridiksional ose tjetër, qoftë i brendshëm apo ndërkombëtar, në mënyrë që të kundërshtojnë ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi të dhënë sipas kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të Rregullores së Huas.

Në çdo veprim ligjor që rrjedh nga kjo Marrëveshje, vërtetimi i CEB-it për shumën e duhur apo normën e zbatueshme të interesit sipas Marrëveshjes, në mungesë të një gabimi të dukshëm, do të jetë provë *prima facie* e një shume ose norme të tillë interesi.

15. NJOFTIMET

Çdo njoftim ose komunikim tjetër që duhet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje ndaj CEB-it ose Huamarrësit, do të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet i dhënë ose i bërë në mënyrën e duhur, kur dërgohet me postë të regjistruar ose faks nga njëra Palë në adresën e palës tjetër, siç specifikohet më poshtë.

Për Huamarrësin dhe vendin përfitues:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Republika e Shqipërisë
Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Faks: +355 4 222 8494
Për CEB-in:
Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim
55 Avenue Kléber
75116 Paris
France
Në vëmendje të Drejtorit, Departamenti i Projekteve
Faks: +33 1 47 55 37 52
Kopje drejtuar: Drejtorit të Strategjisë dhe Bashkëpunimit Evropian
Faks: +33 1 47 55 71 55

Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera që do të jepen ose do të bëhen sipas Marrëveshjes do të jetë në anglisht ose në frëngjisht, ose nëse bëhen në një gjuhë tjetër, do të shoqërohen me përkthim të certifikuar në anglisht ose në frëngjisht, nëse CEB-i e kërkon këtë.

Pa cenuar vlefshmërinë e një njoftimi të dhënë me faks sipas paragrafëve të mësipërm, një kopje e çdo njoftimi të dhënë me faks i dërgohet, gjithashtu, me letër palës tjetër jo më vonë se në ditën pasuese të punës.

Njoftimet e bëra nga Huamarrësi, në pajtim me një dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, nëse kërkohet nga CEB-i, i dorëzohen CEB-it së bashku me provat e pranueshme të autoritetit të personit ose të personave të autorizuar për të nënshkruar këtë njoftim në emër të Huamarrësit dhe ekzemplarët e vërtetuar të firmave të këtij ose këtyre personave.

16. DETYRIMET DHE SHPENZIMET

Huamarrësi duhet të paguajë, në masën e zbatueshme, të gjitha taksat, tatimet, tarifat dhe detyrimet e tjera të çdo natyre, duke përfshirë taksën e pullës dhe tarifat e regjistrimit, që rrjedhin nga ekzekutimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje apo çdo dokumenti tjetër në lidhje me krijimin, realizimin, regjistrimin apo zbatimin e çdo garancie dhe sigurimi të kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Huamarrësi do të përballojë të gjitha detyrimet dhe shpenzimet (duke përfshirë shpenzimet ligjore, profesionale, bankare apo të këmbimit valutor), të shkaktuara në lidhje me: i) përgatitjen, ekzekutimin, zbatimin dhe përfundimin e kësaj Marrëveshjeje apo çdo dokumenti tjetër; dhe ii) për ndryshimin, plotësimin apo heqjen dorë në lidhje me këtë Marrëveshje apo çdo dokument tjetër; dhe iii) për ndryshimin, krijimin, menaxhimin dhe zbatimin e çdo garancie të kërkuar në kuadër të Huas.

Pavarësisht nga sa më sipër, neni 4.7 (Kostoja e arbitrazhit) i Rregullores së Huas do të zbatohet në lidhje me shpenzimet e arbitrazhit, të përcaktuara në klauzolën 14.

17. PËRMBUSHJA E DETYRËS

Pas shlyerjes të të gjithë principalit të papaguar sipas Huas, si dhe pagesës së të gjitha interesave dhe

shpenzimeve të tjera që rezultojnë nga Marrëveshja, duke përfshirë në veçanti ato shuma sipas nënklauzolës 4.9 dhe klauzolës 16, Huamarrësi do të lirohet plotësisht nga detyrimet e tij ndaj CEB-it, me përjashtim të atyre të përcaktuara në pikën 6 më sipër për qëllimet e një vlerësimi të mundshëm të Projektit, e cila nuk do të bëhet më vonë se 2 (dy) vjet pas shlyerjes së të gjithë principalit të papaguar sipas Huas.

18. HYRJA NË FUQI

Marrëveshja do të hyjë në fuqi pas ekzekutimit nga Palët dhe ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

19. AMENDAMENTET

Çdo ndryshim ose modifikim i kësaj Marrëveshjeje duhet të bihet dakord në mënyrë të rregullt dhe me shkrim ndërmjet Palëve.

Për Huamarrësin dhe vendin përfitues, ministri i Financave është i autorizuar që të nënshkruajë çdo amendament i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Amendamente në këtë Marrëveshje që ndikojnë vetëm në datën e mbylljes dhe/ose një periudhë alokimi nuk do të kërkojnë miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave.

Në dëshmi të kësaj, Palët hartojnë 2 (dy) kopje origjinale, secila prej tyre është njëlloj e vlefshme dhe kanë bërë që nënshkruesit e specifikuar më poshtë të siglojnë çdo faqe të kësaj Marrëveshjeje në emër të tyre. Secila prej Palëve mban 1 (një) origjinal.

[•], më [•]

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

_____

Ministri i Financave

Paris, më [•].

Për Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës

_____

[Guvernatori/zëvendësguvernatori]

SHTOJCA 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

I.	**LD**	LD 1853 (2014)
	Huamarrësi	Republika e Shqipërisë
	Lloji i Huas	Hua Projekti për financimin e fazës së katërt të Programit të Punëve në Komunitet të titulluar "Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare"
	Shuma e Huas	28,700,000 euro
	Aprovimi nga Këshilli Administrativ i CEB-it	6 nëntor 2014

II.	**Sektori/sektorët e veprimit**	Përmirësimi i kushteve të jetesës në zonat urbane dhe rurale
	Punimet/komponentët e parashikuar	Qëllimi kryesor i Programit është të promovojë zhvillimin lokal në komunitetet brenda zonave të synuara duke përmirësuar infrastrukturën vendore, në respekt të mjedisit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe historike. Programi parashikon financimin e ndërhyrjeve të infrastrukturës publike në Bregdetin e Jugut, në zonën e Alpeve (dhe zona të tjera malore). Llojet kryesore të nënprojekteve do të jenë rigjallërimi urban, rrugët urbane dhe rurale, trotuaret dhe sheshet, furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza, si dhe hapësira rekreative, ndriçimi publik dhe ndërhyrjet mjedisore apo kulturore të orientuara. Tri nënprojekte që i shpjegojnë më së miri* llojet e ndërhyrjeve që do të financohen nga CEB-i përfshijnë: a) ndërtimin e një rruge urbane në Bashkinë e Sarandës; b) ndërtimi i një rrjeti të ujësjellësit në fshatrat e Valbonës dhe të Rragamit; dhe c)

<table>
<tr><td></td><td>Rikonstruksioni i rrugëve të fshatit të Dhërmiut në Bregdetin e Jugut.
* Këto projekte janë shembuj, një vendim do të merret për përfshirjen e tyre në Projekt gjatë përgatitjes së planeve përkatës të punës.</td></tr>
<tr><td>Vendndodhja</td><td>Zona e Alpeve Shqiptare dhe e Bregdetit të Jugut. Zona të tjera malore (parqet e malit të Dajtit ose të Tomorit) mund të merren në konsideratë.</td></tr>
<tr><td>Përfituesit përfundimtarë</td><td>Popullsia rezidente e këtyre zonave lokale.</td></tr>
<tr><td>Kostoja e përgjithshme e Projektit</td><td>Parashikuar në vlerën 36,700,000 euro.</td></tr>
<tr><td>Plani i Financimit</td><td>Shpenzimet e parashikuara janë planifikuar të mbulohen nga burimet financiare (në milionë euro) të mëposhtme):
EURO 28.7 Huaja e CEB-it; dhe
EURO 1.0 Granti SDA i CEB-it për AT-në.
EURO 29.7 Totali i CEB-it
EURO 6.0 Qeveria e Shqipërisë dhe NJQV-të
EURO 1.0 Granti i WBIF[1]

<table>
<tr><th></th><th>CEB</th><th>Shqipëria dhe NJQV-të</th><th>WBIF</th><th>Totali</th></tr>
<tr><td>Kostoja e Investimeve</td><td>27.5</td><td>5.0</td><td></td><td>32.5</td></tr>
<tr><td>Punimet civile</td><td>25.3</td><td>4.6</td><td></td><td>29.9</td></tr>
<tr><td>Projektimi dhe mbikëqyrja</td><td>2.2</td><td>0.4</td><td></td><td>2.6</td></tr>
<tr><td>Mallrat</td><td>0.2</td><td></td><td></td><td>0.2</td></tr>
<tr><td>Kostot e zbatimit dhe të AT-së</td><td>1.0</td><td>1.0</td><td>1.0</td><td>3.0</td></tr>
<tr><td>Fondi i shpenzimeve të paparashikuara</td><td>1.0</td><td></td><td></td><td>1.0</td></tr>
<tr><td>TOTALI</td><td>29.7</td><td>6.0</td><td>1.0</td><td>36.7</td></tr>
</table></td></tr>
<tr><td>Afati i parashikuar i punimeve/vitet buxhetore të parashikuara</td><td>2015-2019</td></tr>
<tr><td>Data e përfundimit</td><td>30 shtator 2019</td></tr>
</table>

III.	**Kriteret e përzgjedhjes**	Projektet me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat urbane duhet të përfshijnë lagjet e lëna pas dore ose zonat urbane të cilave iu mungon infrastruktura urbane dhe/ose mjediset sociale dhe kulturore. Projektet që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale duhet të përfshijnë rajone të karakterizuara nga një dendësi e ulët e popullsisë apo aktivitete në fusha të tilla, si: bujqësia, pylltaria, akuakultura dhe peshkimi, të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar. CEB-i financon projekte që përfshijnë ndërtimin apo rehabilitimin e infrastrukturës publike në sektorët e rehabilitimit urban dhe modernizimit rural. Vetëm ato investime në infrastrukturë që përfshihen në buxhetin kombëtar, rajonal apo vendor, do të konsiderohen të pranueshme, të tilla si:

[1]Në kuadër të Kornizës për Investime në Ballkanin Perëndimor (WBIF), Republikës së Shqipërisë i është dhënë nga Fondi i Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor (EWBJF) një fond prej 1,000,000 eurosh për asistencë teknike në mbështetje të projektit "Punimet e Infrastrukturës Vendore në Zonën e Alpeve të Shqipërisë" me nr. ref. WB6-ALB-SOC-14 dhe ku CEB-i është caktuar si institucioni financiar kryesor.

	i) shërbime si rrjeti i ujësjellësit, i energjisë elektrike dhe furnizimit me gaz, rrjeti i kanalizimeve, trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme; ii) ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor lokal; iii) infrastruktura dhe mirëmbajtja e transportit publik lokal; iv) ndriçimi publik; v) ngrohja qendrore; vi) objektet kryesore arsimore dhe mjekësore; vii) qendra social-kulturore apo sportive, të tilla si: terrene sportive, hapësirat e gjelbra, mjediset e ekspozitave, teatro dhe biblioteka; viii) zhvillimi i zonave industriale; xix) rrjetet e ujitjes në zonat rurale; x) ndërtesa administrative dhe strehimi publik. Huamarrësi nuk mendon që ndërtimi i infrastrukturave publike, i parashikuar në kuadër të këtij programi, do të ketë një ndikim mbi pronën private apo do të kërkojë shpronësime dhe/ose rivendosje të banorëve. Megjithatë, Huamarrësi deklaron se NJZP-ja do të jetë përgjegjëse për të garantuar se nëse ndodh një rast i tillë, ai do të trajtohet sipas ligjit për shpronësim nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore, e cila, së bashku me Ministrinë e Brendshme, janë autoritetet përkatëse që merren me procedurat e shpronësimit. CEB-i rezervon të drejtën për të hequr nga lista e identifikimit të nënprojekteve të Programit çdo investim të cilin e konsideron në papajtueshmëri me standardet e tij dhe të kërkojë zëvendësimin e tij me një nënprojekt të ndryshëm, të cilit do t'i alokohen fondet e CEB-it. Ky Program përfaqëson vazhdimësinë e bashkëpunimit të mëparshëm ndërmjet CEB-it, Huamarrësit dhe NJZP-së në fushën e zhvillimit rural.
Kostot e pranueshme	Kostot e pranueshme për financimin nga CEB-i përfshijnë: i) Kostoja e vlerësimeve apo të studimeve (teknike, ekonomike, tregtare apo inxhinierike), si dhe kostoja e mbikëqyrjes teknike të projektit; ii) Kostoja e sigurimit të truallit që lidhet drejtpërsëdrejti me një projekt, me çmimin e blerjes, nëse nuk është dhuruar ose është dhënë; iii) Përgatitja e truallit; iv) Ndërtimi/rinovimi/modernizimi ose blerja e një ndërtese që lidhet drejtpërdrejt me një projekt; v) Instalimi i infrastrukturës bazë, të tilla si: kanalizimet, furnizimi me ujë, rrjetet e energjisë elektrike dhe të telekomunikacionit, trajtimi i mbeturinave dhe i ujërave të zeza, rrugët etj.; vi) Blerja e materialeve, pajisjeve dhe makinerive; vii) Fondet për shpenzimet e paparashikuara (rritja teknike dhe/ose e çmimeve), mund të financohen nga CEB-i. Këto përfaqësojnë mbulimin financiar në lidhje me ndryshimet e mundshme të sasisë së punës së kërkuar, në llojin dhe sasinë e pajisjeve që do të blihen ose në mënyrën e zbatimit të Projektit. Kostot financiare ose investimet (pagesa e borxheve, rifinancimi, detyrimet e interesit etj.) nuk mund të përfshihen në koston e parashikuar të Projektit dhe nuk mund të financohen nga CEB-i. Shpenzimet e TVSH-së janë të përjashtuara nga kostot e pranueshme.
Kushtet specifike	KUSHTET SHTESË PËR DISBURSIMIN sipas - Nënparagrafit 4.5/a(iii) (*Kushtet pararendëse të disbursimit të transhit të parë*): Republika e Shqipërisë do t'i komunikojë CEB-it të dhënat e llogarisë së veçantë, të përshkruar në klauzolën 4.2.

IV	**Ndikimi social**	Programi pritet të përmirësojë kushtet e jetesës së popullsisë vendëse në zonën e synuar dhe, përveç kësaj, të krijojë një numër të konsiderueshëm përfitimesh social-ekonomike dhe mjedisore dhe për këtë arsye të krijojë kushtet për rritjen e të ardhurave të popullsisë vendëse, rritjen e investimeve publike dhe private në zonë dhe të kontribuojë në ruajtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore. Programi mund të kontribuojë në mënyrë indirekte për të: i) zvogëluar papunësinë dhe punësimin e përkohshëm në zonë nëpërmjet krijimit të vendeve të reja të punës dhe intensifikimit të aktiviteteve ekonomike ekzistuese; ii) reduktuar numrin e familjeve që jetojnë nën nivelin e varfërisë; dhe iii) përmirësuar cilësinë e shërbimeve bazë dhe, si një rrjedhim logjik, mund të çojë në rritjen e ofertave turistike, në kohëzgjatjen e pushimeve dhe rritjen e shpenzimeve të vizitorëve.

SHTOJCA 2
FORMULARI I OPINIONIT LIGJOR

Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim
55, Avenue Kléber
F-75116 Paris
Për vëmendje të: Departamentit të Projekteve
Për dijeni: Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm

[VENDOSNI DATËN]

Lënda: Marrëveshja Kuadër e Financimit ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Republikës së Shqipërisë

E nderuar Znj./Z.,

Unë, [●], në cilësinë time si [VENDOSNI FUNKSIONIN (p.sh, Ministër i Financave, Drejtues i Shërbimeve Ligjore)], kam vepruar si këshilltar ligjor për çështjet e ligjit [VENDOSNI JURIDIKSIONIN], në Republikën e Shqipërisë ("Huamarrësi" dhe "Vendi përfitues"), në lidhje me Marrëveshjen Kuadër të Financimit për projektin me nr. Ref: LD 1853 (2014) dhe At-në e projektit me nr. ref. SDA-13-TA (2014) ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës ("CEB") dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e Huamarrësit dhe vendit përfitues, të datës [●] dhe hyrjes në fuqi në datën [●] ("Marrëveshja") dhe jap këtë mendim në pajtim me nenin [●] të Marrëveshjes.

Për qëllimet e këtij opinioni, ne kemi shqyrtuar një kopje të Marrëveshjes dhe dokumente të tjera, si akte apo traktate, siç e kemi konsideruar të nevojshme ose të dëshirueshme në mbështetje të këtij opinioni.

Termat e përcaktuar në Marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim në këtë dokument, përveç nëse specifikohet ndryshe.

Mbështetur sa më sipër, Unë parashtroj opinionin që:

Kapaciteti, pushteti dhe autoriteti. Republika e Shqipërisë ka zotësinë juridike, pushtetin dhe autoritetin për të hyrë në Marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet në përputhje me këtë Marrëveshje.

Autorizimet e brendshme. Të gjitha veprimet që i janë kërkuar Republikës së Shqipërisë për ekzekutimin, dorëzimin dhe performancën e Marrëveshjes, duke përfshirë çdo autorizim të kërkuar nga organet e saj kompetente, janë kryer si duhet dhe në mënyrë efektive. Në veçanti, nuk kërkohet ndonjë veprim i mëtejshëm nga Republika e Shqipërisë, përveç ekzekutimit nga një përfaqësues i autorizuar i Republikës së Shqipërisë, me qëllim lëshimin e Kërkesës për Disbursimin e Grantit ose Kërkesën e Disbursimit të Huas, siç mund të jetë rasti, sipas Marrëveshjes.

Ekzekutimi i duhur dhe vlefshmëria. Marrëveshja u ekzekutua në mënyrë të rregullt nga [VENDOSNI EMRIN E NËNSHKRUESIT] si përfaqësues / përfaqësuesit e autorizuar të Republikës së Shqipërisë dhe i hap rrugën angazhimeve ligjore të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë

Autorizimet e jashtme, aprovimet dhe dokumentimet publike. Asnjë autorizim, aprovim, licencë, përjashtim nga detyrimet, dokumentim, noterizim apo regjistrim nuk është i nevojshëm për [VENDOS JURIDIKSIONIN], në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin ose përmbushjen e Marrëveshjes, me qëllim që t'i

hapë rrugë angazhimeve ligjore të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë dhe për Marrëveshjen, që të jenë të pranueshme në dëshmi të [VENDOSNI JURIDIKSIONIN].

Detyrimet taksore. Ekzekutimi i Marrëveshjes nuk është subjekt i ndonjë tatimi ose takse të pullës në [VENDOSNI JURIDIKSIONIN].

Zgjedhja e ligjit. Pajtueshmëria nga ana e Republikës së Shqipërisë me rregullat e CEB-it, siç përcaktohet në dispozitat e nenit 1, paragrafi 3, të Protokollit të Tretë (të datës 6 mars 1959), të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës (datë 2 shtator 1949) dhe, së dyti, me ligjet e Francës është ligjërisht e vlefshme dhe e detyrueshme për Republikën e Shqipërisë sipas ligjeve të [VENDOSNI JURIDIKSIONIN].

Arbitrazhi. Pajtueshmëria nga ana e Republikës së Shqipërisë ndaj Gjykatës së Arbitrazhit, të parashtruar në kapitullin 4 të Rregullores së Huas të CEB-it në lidhje me çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga Marrëveshja është ligjërisht e vlefshme dhe e detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Çdo vendim i një Gjykatë të tillë Arbitrazhi është i zbatueshëm në [VENDOSNI JURIDIKSIONIN] në përputhje me kushtet e nenit 3 të Protokollit të Tretë (të datës 6 mars 1959), të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës (datë 2 shtator 1949).

Me respekt,
[●]

[VENDOSNI EMRIN DHE FUNKSIONIN]

SHTOJCA 3

Kërkesa e Disbursimit të Huas (Formulari)

Në vëmendje të:
Drejtori i Departamentit të Projekteve,
Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim
55, Avenue Kleber
75116 Paris, France
Faks: +33 (0) 1 47 55 37 52

LD 1853 (2014) – [•] Transhi i Huas

Duke iu referuar Marrëveshjes Kuadër të Financimit, të datës [●] (këtej e tutje, "Marrëveshja**"**) ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (këtej e tutje, CEB) dhe [Huamarrësit] (këtej e tutje, "Huamarrësi"), [HUAMARRËSI] me anë të kësaj letre i kërkon CEB-it, në përputhje me nënklauzolën 4.3 a) të Marrëveshjes, të vazhdojë me disbursimin e Transhit sipas kushteve dhe termave specifikë të përcaktuar më poshtë:

Termat e përcaktuar në Marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim, përveç nëse specifikohet ndryshe.

Monedha/shuma	[●]
Data e disbursimit	[●]
Periudha e shlyerjes së principalit	[●] vitet [duke përfshirë një periudhë shtyrje prej [●] vitet]
Data/datat e shlyerjes së principalit	[●]

Data e maturimit	[●]			
Norma e interesit	Fikse	[●] *për vit*		
	E ndryshueshme	Norma e Referencës:	[●]-muaji EURIBOR/VENDOSNI NJË NORMË TJETËR REFERENCE] *për vit*	
		Diferenca	[●] pikëbaza për vit	
Periudha e interesit	[tremujore] [gjashtëmujore] në kamatë			
Datat e pagesës së interesit	Pagesa e interesit do të kryhet në datën [●] çdo vit dhe për herë të parë në datën [●]			
Konventa e llogaritjes së ditëve	Konventa e Modifikimit të Ditës Pasardhëse të Punës			
Dita e punës	Çdo ditë në të cilën operon TARGET 2 (*TARGET Sistemi automatik Transeuropian i Transfertave në shuma të mëdha në kohë reale*)			
Llogaria e Projektit të Huamarrësit	Emri i përfituesit			
	Banka e përfituesit	Emri	[●]	
		Qyteti	[●]	
		SWIFT	[●]	
		IBAN	[●]	
		Referenca	[●]	
	Banka korrespondente (nëse është e aplikueshme)	Emri	[●]	
		Qyteti	[●]	
		SWIFT	[●]	
		IBAN	[●]	

Më datë [•], [•]

Për Huamarrësin

[VENDOSNI EMRAT/FUNKSIONET]

NJOFTIMI I DISBURSIMIT (MODEL)

LD 1853 (2014) – [•] Transhi i Huas

Në përgjigje të Kërkesës suaj të Disbursimit, të datës [●] duke iu referuar Marrëveshjes Kuadër të Financimit, të datës [●] (më poshtë e quajtur "Marrëveshja") ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (më poshtë e quajtur CEB) dhe [Huamarrësit] (më poshtë e quajtur "Huamarrësi") CEB-i, me anë të këtij dokumenti e njofton Huamarrësin në përputhje me nënklauzolën 4.3/b të Marrëveshjes, mbi kushtet dhe termat e disbursimit të transhit përkatës.

Termat e përcaktuar në Marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim në këtë njoftim, përveç nëse specifikohet ndryshe.

Monedha/shuma	[●]		
Data e disbursimit	[●]		
Periudha e shlyerjes së principalit	[●]vitet [duke përfshirë një periudhë shtyrjeje prej [●] vitesh]		
Data/datat e shlyerjes së principalit	[●]		
Data e maturimit	[●]		
Norma e interesit	Fikse	[●] *për vit*	
	E ndryshueshme	Norma e referencës:	[●]-muaji EURIBOR/VENDOSNI NJË NORMË TJETËR REFERENCE] *për vit*
		Diferenca	[●] pikëbaza për vit
Periudha e interesit	[tremujore] [gjashtëmujore] në kamatë		
Datat e pagesës së interesit	Pagesa e interesit do të kryhet në datën [●] çdo vit dhe për herë të parë në datën [●]		
Konventa e llogaritjes ditëve	Konventa e Modifikimit të Ditës Pasardhëse të Punës		
Dita e punës	Çdo ditë në të cilën operon TARGET 2 (*TARGET Sistemi Automatik TransEuropian i Transfertave në Shuma të Mëdha në Kohë Reale*)		

Llogaria e Projektit të Huamarrësit	Emri i përfituesit		
	Banka e përfituesit	Emri	[●]
		Qyteti	[●]
		SWIFT	[●]
		IBAN	[●]
		Referenca	[●]
	Banka korrespondente (nëse është e aplikueshme)	Emri	[●]
		Qyteti	[●]
		SWIFT	[●]
		IBAN	[●]
Llogaria e CEB-it	Emri i përfituesit	Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës	
	SWIFT i përfituesit	CEFPFRPP	
	Banka e përfituesit	Emri	Deutsche Bank
		Qyteti	Frankfurt (Gjermani)
		SWIFT	DEUTDEFF
		IBAN	DE44500700100928738400

Paris, më [•]

Për CEB-in

[VENDOSNI EMRIN DHE FUNKSIONIN]

SHTOJCA 4
RAPORTET E PROGRESIT

LD 1853 (2014) – SHTOJCA 4. RAPORTI I MONITORIMIT

TABELA E LËNDËS

Shtojca 4a	Raporti përshkrues i monitorimit
Shtojca 4b	Tabela 1. Kostot
Shtojca 4c	Tabela 2A. Plani i prokurimit
Shtojca 4d	Tabela 2B. Lista e kontratave të fituara
Shtojca 4e	Tabela 3A. Përdorimi i Grantit të CEB-it
Shtojca 4f	Tabela 3B. Përdorimi i Huas së CEB-it
Shtojca 4g	Tabela 4. Plani i financimit
Shtojca 4h	Tabela 5. Grafiku i aktiviteteve
Shtojca 4i	Tabela 6. Treguesit teknikë të Projektit

SHTOJCA 4A
RAPORTI PËRSHKRUES I MONITORIMIT

LD 1853 – Punët në komunitet. Faza e katërt (4)	
Kostoja e parashikuar e Projektit:	***Përshkrim i shkurtër:***
Kuadri i shumës së Huas:	
Burime të tjera financiare:	
Data e hyrjes në fuqi:	***Agjencia Zbatuese: FSHZH***
Data e planifikuar e përfundimit:	
Vitet e zbatimit:	
% e disbursuar deri më (data)	***Historiku i Disbursimit*** (*fundi i periudhës*)
	Aktuale
	E parashikuar
	Bashkëlidhur informacion i përditësuar për Disbursimin
Përmbledhja e statusit të Projektit:	
Gjendja e Zbatimit të Projektit deri më sot është si më poshtë:	

Administrimi i Projektit

Kostoja dhe financimi i Projektit

Aktivitetet financiare për zbatimin e Projektit gjatë (*periudha***) Aktivitetet për zbatimin e projektit teknik gjatë (***periudha***) Aktivitetet e Prokurimit gjatë** *(periudhës)*

Plani i Propozuar i Aktiviteteve të Prokurimit

Monitorimi dhe VLERËSIMI

Çështje specifike/sugjerime/rekomandime të Projektit

Drejtori i NJZP-së:

SHTOJCA 4B

TABELA 1 – KOSTOT

Kostot

Në monedhën vendëse (taksat dhe TVSH të përjashtuara)

HUAMARRËSI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Data:.....
PROJEKTI: LD 1853 – FSHZH PUNËT NË KOMUNITET 4
AGJENCIA ZBATUESE: FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (FSHZH)

Përshkrimi				Kostot e planifikuara	Shpenzimet e kryera deri më (datë)			SHPENZIMET E ARDHSHME		KOSTOJA TOTALE	% E SHPENZUAR	KOMENTE
Nr	Qarku	Komuna	Përshkrimi i Projektit		PERIUDHA 1 [1]	PERIUDHA 2 [1]	TOTALI	Deri në përfundim	PREJ TË CILAVE NË 12 MUAJT E ARDHSHËM			
					1	2	3 = 1+2	4	5	6 = 3+4	7 = 3/6	
1												
2												
3												
4												
5												
6												
...												
Totali sipas qarqeve												
MENAXHIMI I PROJEKTIT												
TOTALI												

[1] *Ju lutem zëvendësoni numrin e periudhave me vitin e referuar dhe shtoni kolona sipas progresit të shpenzimeve vjetore*

Shtojca 4c

TABELA 2A – PLANI I PROKURIMIT
TABELA 2A PLANI I PROKURIMIT PËR VITIN XXXX
HUAMARRËSI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI: LD 1853-FSHZH PUNËT NË KOMUNITET FAZA 4
AGJENCIA ZBATUESE: FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (FSHZH)

1. Punimet Civile

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Ref. Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Kostoja e parashikuar e monedhës	Kostoja e parashikuar në euro	Financuar nga	Numri i loteve	Metoda e prokurimit	Preferenca e brendshme (po/jo) %	Vlerësim nga Banka (PARA/PAS)	Data e parashikuar e fillimit të tenderit	Data e parashikuar e hapjes së tenderit	Data e parashikuar e vlerësimit të tenderit	Data e parashikuar e nënshkrimit të kontratës

2. Mallrat

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Ref. Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Kostoja e parashikuar e monedhës	Kostoja e parashikuar në euro	Financuar nga	Numri i loteve	Metoda e prokurimit	Preferenca e brendshme (po/jo) %	Vlerësim nga Banka (PARA/PAS)	Data e parashikuar e fillimit të tenderit	Data e parashikuar e hapjes së tenderit	Data e parashikuar e vlerësimit të tenderit	Data e parashikuar e nënshkrimit të kontratës

3. Parashikimet

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Ref. Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Kostoja e parashikuar e monedhës	Kostoja e parashikuar në euro	Financuar nga	Numri i loteve	Metoda e prokurimit	Preferenca e brendshme (po/jo) %	Vlerësim nga Banka (PARA/PAS)	Data e parashikuar e fillimit të tenderit	Data e parashikuar e hapjes së tenderit	Data e parashikuar e vlerësimit të tenderit	Data e parashikuar e nënshkrimit të kontratës

SHËNIM: Kolona e Preferencës së Brendshme duhet të plotësohet vetëm në rast të Metodës së Prokurimit Konkurues Ndërkombëtar (PKN), në rastin e Metodave të tjerë të Prokurimi, ju lutem vendosni "N/A".

Kolona 5: Ju lutem specifikoni burimin e pritshëm të financimit që do të përdoret, psh: CEB, Institucione të tjera Financiare Ndërkombëtare, Buxheti i Shtetit, Fonde të veta të Përfituesit, etj.

Shtojca 4d

Tabela 2B – Lista e kontratave fituese

TABELA 2b LISTA E KONTRATAVE FITUESE

HUAMARRËSI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI: LD 1853 - FSHZH PUNET NË KOMUNITET FAZA 4 **Data progres raportit:……..**
AGJENCIA ZBATUESE: FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (FSHZH)
pa TVSH

Përshkrimi I Kontratës			Furnizuesi/Kontraktori		Kushtet e Kontratës			Data e nënshkrimit të Kontratës	Kohëzgjatja e Kontratës *(në muaj)*	Kategoria e Kontratave [2]	Procedurat e ndjekura të prokurimit		Shortlista ose parakualifikimi (nëse është i aplikueshëm)		Paguar		Periudha e zbatimit		Data e marrjes së punës	Modifikime/Komente
Ref.	Titulli	Objekti i kontratës	Emri	Vendi	Monedha	Shuma	Ekuivalenti në euro						Numri i Kandidatëve aplikues	Numri I kandidatëve të përzgjedhur	Në monedhën vendëse	Ekuivalenti në euro [4]	Fillimi	Përfundimit		
											Metoda[3]									
											Data e njoftimit të kontratës									
											Ofertat e marra në:									
											Vendimi i ofertave fituese në datën:									
											Numri i ofertave të marra:									
											Numri i ankesave/apelimeve të marra (P për PO; J për J)									
											Metoda [3]									
											Data e njoftimit të kontratës									
											Ofertat e marra në datën:									
											Vendimi i ofertës fituese:									
											Numri I ofertave të marra:									
											Ankesat / Apelimet e marra: (P për PO; J për J)									
											Metoda [3]									
											Data e njoftimit të kontratës									
											Ofertat e marra në datën:									
											Vendimi i ofertës fituese									
											Numri I ofertave të marra									
											Ankesat / Apelimet e marra: (P për PO; J për J)									

[1]KV - Kundravlera në EUR sipas kursit të këmbimit zyrtar në datën e nënshkrimit të kontratës

[2]Akronimet që do të përdoren: **P** për Punimet, **M** për Mallrat dhe **SH** për Shërbimet.

[3]Akronimet që do të përdoren: për **Procedura të Prokurimit Ndërkombëtar**: **OP** = Procedurë e Hapur; **RP** = Procedurë e Kufizuar; **CD** = Procedurë Konkuruese; **NPP** = Procedura të Negociuara me Shpallje; **NPNP** = Procedura të Negociuara pa Shpallje

Akronimet që do të përdoren për **Procedura të Prokurimit Kombëtar**: **NCT** = Tenderim Konkurrues Kombëtar; **DC** = Kontraktim i Drejtpërdrejtë (me aprovim paraprak të CEB); **SH** = Blerje; **BOR** = Burime të Veta të Huamarrësit

[4]KV - Kundravlera në EUR sipas kursit të këmbimit zyrtar në datën e pagesës

Shtojca 4e

Tabela 3A – Përdorimi i Grantit të CEB

TABELA 3A - Pasqyra e llogarisë së Grantit SDA të CEB-it

VENDI: SHQIPËRIA

PROJEKTI: LD 1853 - FSHZH PUNËT NË KOMUNITET FAZA E KATËRT

HUAMARRËSI: Republika e Shqipërisë

1 000 000 **euro**

Nr. i TRANSHIT	Data e Disbursimit	SHUMA E TRANSHIT TË DISBURSUAR (NË EURO)	KURSI I KËMBIMIT (NË DITËN E TRANSFERTËS)	EKUIVALENTI NË LEKË	PAGESAT PËR SHPENZIMET E PROJEKTIT				Komente dhe modifikime
					Data	Përshkrimi	Shuma e paguar	KURSI I KËMBIMIT në datën e pagesës	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
						TOTALI I PËRGJITHSHËM			

Shtojca 4f

Tabela 3B – Përdorimi i Huas së CEB-it

TABELA 3B – Pasqyra e llogarisë së Huas së CEB-it

VENDI: SHQIPËRIA

PROJEKTI: LD 1853 (2014) – FSHZH PUNËT NË KOMUNITET FAZA E KATËRT

HUAMARRËSI: Republika e Shqipërisë

Nr. i transhit	**Data e disbursimit**	**SHUMA E TRANSHIT TË DISBURSUAR** (NË EURO)	**KURSI I KËMBIMIT** (NË DITËN E TRANSFERTËS)	**EKUIVALENTI** NË LEKË	**PAGESAT PËR SHPENZIMET E PROJEKTIT**				**Komente dhe modifikime**
					Data	**Përshkrimi**	**Shuma e paguar**	**KURSI I KËMBIMIT në datën e pagesës**	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
TOTALI I PËRGJITHSHËM									

SHTOJCA 4G

TABELA 4 – PLANI I FINANCIMIT

Plani i financimit

në euro (pa përfshirë TVSH-në)

Huamarrësi: REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROJEKTI: LD 1853 – FSHZH PUNËT NË KOMUNITET FAZA E KATËRT **Date: ……**

AGJENCIA ZBATUESE: FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (FSHZH)

Njësia	Kostot e parashikuara në vlerësim	PAGUAR NGA DERI MË [*Datë*]					PËR T'U PAGUAR NË GJASHTË MUAJT E ARDHSHËM DERI MË *Datë*]					KOMENTE
		Granti i CEB-it nga SDA	Huaja e CEB-it	Qeveria Shqiptare dhe përfituesit	WBIF	TOTALI	Granti i CEB-it nga SDA	Huaja e CEB-it	Qeveria Shqiptare dhe përfituesit	WBIF	TOTALI	
1	2	3		4	5	6	7		8	9	10	11
KOSTO INVESTIMI												
PUNIME CIVILE												
PROJEKT-DIZAJN & SUPERVIZIMI												
ASISTENCA TEKNIKE												
TRAJNIME												
MALLRA												
KOSTOT E MENAXHIMIT TË NJZP-së												
FONDET REZERVË												
SHUMA E PËRGJITHSHME												

Tabela 5 - Plani i Punës Shtojca 4h

PLANI I PUNES*

DIAGRAMA

HUAMARRESI: REPUBLIKA E SHQIPERISE **Data: .....**

PROJEKTI: LD 1853 – FSHZH PUMET NE KOMUNITET FAZA 4

AGJENCIA ZBATUESE: FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (FSHZH)

PERSHKRIMI				VITI 1 **		VITI 2 **		VITI 3 **		VITI 4 **		% PROGRESI PUNIMEVE FIZIKE	KOMENTET E NDRYSHIMEVE
Nr	Pershkrimi	NJQV	Plani	Sem I	Sem II	Sem I	Sem II	Sem I	Sem II	Sem I	Sem II		
1			Planifikuar										
			Rishikuar										
2			Planifikuar										
			Rishikuar										
3			Planifikuar										
			Rishikuar										
4			Planifikuar										
			Rishikuar										
5			Planifikuar										
			Rishikuar										
6			Planifikuar										
			Rishikuar										
7			Planifikuar										
			Rishikuar										

* *Kjo tabelë do të përditësohet sipas planit të prokurimit.*

** *Ju lutem zëvendësoni numrin e periudhës me vitin referues dhe shtoni kolonat sipas progresit të punës.*

SHTOJCA 4I

Tabela 6
Treguesit teknikë të Projektit

HUAMARRËSI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI: LD 1853 - FSHZH PUNET NË KOMUNITET FAZA 4 **Data:……..**
AGJENCIA ZBATUESE: FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (FSHZH)

		Komunitetet rurale	**Zona e Alpeve Shqiptare**				**Zona e Bregdetit të Jugut**					**Zona të tjera malore (Parku i malit të Dajtit, Tomorit etj.)**				
		Numri i projekteve	**Numri i përfituesve**	**Kostoja mesatare për çdo nënprojekt**	**Kostoja mesatare për çdo përfitues**	**Numri i fondit të mirëmbajtjes**	**Numri i projekteve**	**Numri i përfituesve**	**Kostoja mesatare për çdo nënprojekt**	**Kostoja mesatare për çdo përfitues**	**Numri i fondit të mirëmbajtjes**	**Numri i projekteve**	**Numri i përfituesve**	**Kostoja mesatare për çdo nënprojekt**	**Kostoja mesatare për çdo përfitues**	**Numri i fondit të mirëmbajtjes**
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Rezultatet (1)																
E Pritshme (2)																

Lloji [3]	**Numri i nënprojekteve**				**Sasia**				
	Alpet Shqiptare	**Bregdeti i Jugut**	**Zona të tjera malore**	**Totali**	**Njësia**	**Alpet Shqiptare**	**Bregdeti i Jugut**	**Zona të tjera malore**	**TOTALI**
Rrugë					km				
Trotuare					km				
Ndriçim publik					km				
Furnizim me ujë					km				
Kanalizim i ujërave të zeza					km				
Të tjera [4]									
TOTALI									

SHTOJCA 5
PËRSHKRIMI I ASISTENCËS TEKNIKE TË PROJEKTIT

Referenca:	**SDA-13-TA (2014)**
Përfituesi:	Republika e Shqipërisë
Agjencia Zbatuese:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Aprovimi nga Këshilli Administrativ i CEB-it:	6 nëntor 2014
Vlera e aprovuar:	1 000 000 euro
Objektivat:	Kosto të Zbatimit dhe Asistencës Teknike. Ndërsa kostot e zbatimit do të përfaqësonin kryesisht shpenzimet e stafit të FSHZH-së për burimet njerëzore të angazhuara direkt në Program dhe aktivitetet e zbatimit të nënprojekteve, kostot e Asistencës Teknike lidhen direkt me komponentin e Asistencës Teknike të FSHZH-së në kuadër të Projektit (ndërtimi i kapaciteteve, trajnime dhe aktivitete të Asistencës Teknike që programi parashikon të ofrojë për njësitë e qeverisjes vendore të synuara ose ato që përfitojnë nga programi).
Vendndodhja:	Zona e Alpeve Shqiptare dhe në zonën e bregdetit jugor
Ndarja treguese e kostove:	Faza / Në milionë euro / Financuar nga Granti SDA Zbatimi i Programit: 1.7 — EUR 0.7 milion Trajnime dhe aktivitete të tjera të Asistencës Teknike: 0.3 — EUR 0.3 milion **Kostoja totale e aktivitetit: 2.0** Granti i kërkuar: 1.0
Afati kohor: data e përfundimit:	2015 – 31 mars 2019 Asistenca Teknike do të vazhdojë deri në përfundim të Projektit, i planifikuar deri më 2019-n. 30 shtator 2019
Pranueshmëria:	Projekti i Asistencës Teknike është në linjë me Politikën e SDA-së. Granti i SDA-së është për kërkesat e zbatimit të projektit, aktivitetet e Asistencës Teknike, monitorimin dhe raportimin. Projekti i Asistencës Teknike lehtëson Projektin (me numër reference LD 1853 (2014)
Produktet dhe rezultatet e pritura:	Një vlerë prej 2 milionë eurosh ka qenë e buxhetuar në Program për kosto të Asistencës Teknike dhe zbatim për t'u shpenzuar për realizimin e Projektit LD 1853. 1 milion euro nga kjo do të mbulohet nga ky Grant i SDA-së dhe pjesa tjetër nga Qeveria Shqiptare. Në bazë të vlerësimeve duke përdorur programe të mëparshme të ngjashme, kostot e zbatimit janë vlerësuar të arrijnë deri në 70% të grantit SDA dhe përfaqësojnë kryesisht shpenzimet e personelit të Agjencisë Zbatuese për burimet njerëzore të përfshira direkt në Program dhe aktivitetet zbatuese të nënprojekteve. Këtu përfshihet një ekip me kohë të plotë / të pjesshme, me përgjegjësi të qarta të dedikuar për Programin. Në këtë fazë është parashikuar një ekip i fortë shumëdisiplinor prej 13 personash në përbërje të të cilit do të ketë inxhinierë për të menaxhuar kontratat e punimeve civile, një specialist për mbikëqyrjen teknike, një specialist mjedisi, specialistë për aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve dhe të Asistencës Teknike, një specialist nga departamenti i financës dhe specialistë me shpenzime të kufizuara që u është caktuar punë në dobi të Programit (Zyra Juridike dhe e Prokurimeve; Njësia e Administratës; Njësia e Auditit; Njësia e Monitorim-Vlerësimit; Specialist i Informimit dhe Komunikimit), dy shoferë dhe një koordinator programi. Kostot e Asistencës Teknike në vlerë me shumën e mbetur prej 30% nga balanca e Grantit SDA janë të lidhura direkt me komponentin e Asistencës Teknike të Agjencisë Zbatuese të Projektit; ky komponent konsiston në të gjitha aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve, trajnimeve dhe Asistencës Teknike që Programi parashikon të ofrojë për njësitë e qeverisjes vendore të synuara nga/ose përfituese nga Projekti: - Rreth 25 kurse trajnimi të ofruara gjatë zbatimit të projektit për stafin e njësive vendore përfituese; - Rreth 10 punonjës të FSHZH-së të trajnuar nëpërmjet pjesëmarrjes në kurse trajnimesh, vizita studimore dhe shkëmbimi përvojash, konferencash dhe të tjera aktivitete relevante trajnuese dhe edukuese; - Të paktën pesë njësi vendore përfituese të mbështetura me Asistencë Teknike, duke përfshirë përgatitjen e planeve strategjike dhe sektoriale, plane të investimeve kapitale, krijimin e partneriteteve publike-private; studimeve të fizibilitetit dhe të tjera studime në përputhje me nevojat e tyre etj.
Kushte specifike:	E pazbatueshme

SHTOJCA 6
Kërkesa për disbursimin e Grantit të SDA
(Formati)

(Data, vendi)
Për dijeni:
CEB
Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës
55 Avenue Kléber
F – 75116 Paris
FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT (FSHZH)

Titulli i Marrëveshjes Kuadër të Financimit: PUNËT ME KOMUNITETIT IV – Huaja e Projektit – me Asistencë Teknike të financuar nga Granti SDA

Numrat e Referencës: LD 1853 (2014) dhe SDA-13-TA (2014)
Kërkesa për numrin e disbursimit: *(vendos numrin)*
I/e nderuar z./znj.,
Me anë të kësaj letre paraqes kërkesën për disbursimin e (*Vendos numrin e transhit të Grantit*) transhit të Grantit, sipas Marrëveshjes Kuadër të Financimit të përmendur më sipër.
Sasia e kërkuar është euro *(...)*.

Ju lutem, gjeni bashkëlidhur dokumentet mbështetëse të mëposhtme:
- [Raport progresi];
- Parashikimi i qarkullimit monetar.

Disbursimi i Transhit të Grantit duhet të bëhet në llogarinë e Projektit, me të dhënat e mëposhtme:

Emri i mbajtësit:
Nr. IBAN i llogarisë:
SWIFT BIC:

Me anë të kësaj vërtetoj se informacioni që jepet në këtë kërkesë të disbursimit të Grantit SDA për disbursimin e Transhit është i plotë dhe i besueshëm.

Me respekt,

(Nënshkruesi i autorizuar)